

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7655 E martë 18 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

**B**allkani fillon në Rennweg (rrugë në qendër të Vjenës). – vështirë se mund të ketë austriak që nuk e di këtë frazë, e cila i atribuohet ish-kancelarit ...  
Vijon në faqet 20-21

Nga JOHANN SATTLER

Presidenca austriake e Bashkimit Europian  
2018: Siguria dhe Ballkani në fokus



Opinion **i** Ditës

Nga TRËNDAFILE VISHA

Dita e parë e shkollës e "fishirë"  
nga kalendari i një 7-vjeçari

Vijon në faqen 21



INTERVISTA

Politikani: Momenti i vendimit dhe biseda me Bamir Topin

## Oketa largohet nga politika: S'mund të rri në një sallë me trafikantë

Ish-zyrtari i lartë i FRD: Dy mundësitë që të ecësh sot në politikë

VALENTINA MADANI

Gazmend Oketa hyri në politikë si një individ i plotësuar profesionalisht. Në politikë provoi se ka integritet dhe personalitet duke dhënë maksimumin e tij. Shumë shpejt u shndërrua në një politikan me mendime të ...  
Ne faqet 4-5

## NIS APLIKIMI I TARIFES, TABELA PER KUKSIAJET, MJETET E TRANSPORTIT DHE QYTETARET

# RRUGA E KOMBIT, SA DUHET TE PAGUAJME

Dështon protesta e shoqërisë civile kundër aplikimit të tarifës. Kryeministri Rama ndjesë kuksianëve: Çdo taksë për rrugën do kthehet në investim



(Në foto) Makina duke kaluar në sportelet e pagesës së taksës në rrugën e Kombit

Ne faqen 3

DETAJET E TAKIMIT

**Papa Françesku me presidentin: Shqipëria të mos vuajë dimrin demografik si Europa**

Ne faqen 2

REAGON DHE ALEANCA

**Teatri, PS e diskuton sot, hapet gara për disa subjekte.**

**Ndrenika: Pa kulla...**

Ne faqen 6

ÇFARE NDOHDI

**Vrasjet te "Zogu I", prokuroria: Burg përjetë italianit, vrau tre vetë**

Ne faqen 11

DETAJET E PROCESIT

**ALUIZNI: 450 leje legalizimi për Durrësin dhe Kavajën, lista**

Ne faqen 10

LAJMI I ORES SE VONE



**Dosja e "Xibrakës", lirohet nga burgu Ermal Hoxha, nipi i ish-diktatorit**

Ne faqen 11

Reagon MASR: Kallëzimi, në vitet 2012-2013. Dita e parë e shkollës, çfarë tha Rama e Veliaj

## Regjistrime fiktive, gjykata pezullon 16 mësues

Prokuroria: Akuzohen për "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikim i dokumenteve"

NGA NIKOLL PJETËR HYSAJ

**L**USHNJE- Gjikata e Lushnjes ka pranuar kërkesën e prokurorisë së rrethit për pezullimin nga detyra të 16 mësuesve të shkollës 9-vjeçare në Çermë të Divjakës. Ata nuk janë lejuar të ushtrojnë profesionin e tyre



në ditën e parë të shkollës, pasi akuzohen për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve shkollore. Burime zyrtare nga organi i akuzës dje bënë me dije se kërkesa për pezullim është bërë regjistrimi fiktiv i nxënësve në këtë shkollë me ...  
Ne faqen 9

## PRITJA E PAPËS KREU I SHTETIT

Presidenti i Republikës pritet në një audiencë të veçantë nga Ati i Shenjtë

# Papa Françesku, Metës: Shqipëria të mos vuajë dimrin demografik si Europa

Kreu i shtetit: "Bashkëpunim ndëretnik e ndërftetar në rajon"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u prit dje, në një audiencë të posaçme nga Papa Françesku, në Selinë e Shenjtë në Vatikan. Presidenti Meta shprehu mirënjohjen e thellë për kontributin e jashtëzakonshëm të Selisë së Shenjtë në rimëkëmbjen shpirtërore e sociale të komunitetit katolik dhe popullit shqiptar, veçanërisht pas daljes së vendit nga izolimi i gjatë komunist dhe vendosjes së pluralizmit në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë Presidenti Meta e falënderoi Papa Françeskun, për lartësimin mbarëbotëror të simbolit më domethënës shpirtëror të kombit shqiptar, Nënë Terezës, përmes shenjtërimit të saj. Duke shprehur mirënjohjen për vëmendjen e veçantë që Papa Françesku ka treguar për popullin shqiptar, Presidenti Meta, e siguroi Atin e Shenjtë për vokacionin e qartë e të pandryshuar evropian të Shqipërisë dhe shqiptarëve dhe vendosmërinë e tyre për të ecur në rrugën e integritimit evropian. "Shenjtërimi i Nënë Terezës, si dhe lumturimi i 38 martirëve të Kishës Katolike shqiptare dhe emërimi i At Ernest Troshanit si Kardinal Nderi në Vatikan, na bëjnë krenarë në shqiptarët dhe na japin më shumë besim e forcë për ta ruajtur e promovuar me vendosmëri e përkushtim bashkëjetesën e harmoninë shembullore ndërftetare e kanonike" - nënvizoi Presidenti Meta. "Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriot Skënderbeut na rikthen në kujtesën tonë jo vetëm marrëdhënien e ngushtë të Heroit tonë Kombëtar me Selinë e Shenjtë, por edhe rolin e tij të pazëvendësueshëm në mbrojtjen e civilizimit evropian duke përcaktuar qartë identitetin evropian të shqiptarëve", - vuri në dukje Presidenti Meta gjatë takimit me Atin e Shenjtë. Të dy bashkëbiseduesit nënvizuan rëndësinë e jashtëzakonshme që merr në ditët e sotme modeli shqiptar i harmonisë ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare, si dhe ranë dakord për të vijuar bashkëpunimin e ngushtë mes Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për promovimin e mëtejshëm të kësaj vlere në mbarëbotën. Një mirënjohje të veçantë Presidenti Meta e shprehu edhe për mbështetjen e vyer që Papa Françesku dhe Selia e Shenjtë i kanë dhënë Kosovës dhe, ku padyshim lartësimi në ditën e Shën Terezës së Kishës katolike të Prizrenit në Dio-



### TAKIMI ME SEKRETARIN E VATIKANIT

Duke u ndalur në trashëgiminë e bashkëjetesës së shkëlqyer fetare në Shqipëri dhe mes shqiptarëve, Presidenti Meta falënderoi Atin e Shenjtë për vlerësimin e veçantë ndaj këtij thesari kombëtar si model dhe shembull i vyer në nivel rajonal e global. "Bota sot ka nevojë për mesazhe të tilla bashkëjetese dhe harmonie." - theksoi Presidenti Meta.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë takimit të djesmë me Papa Françeskun, në Selinë e Shenjtë në Vatikan

Ministri: E djathta, sot në opozitë, nuk di të këndojë një këngë të vetën

## Opozita e denoncoi, Majko: Bravo i goftë shkollës që këndoï këngë partizane

Pas denoncimit të bërë nga deputeti i PD për qarkun e Fierit, Enkelejd Alibeaj, në një postim në "Facebook", ku shkruante se në ditën e parë të fillimit të shkollës nxënësit janë pritur me këngë partizane, reagoi ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko. Majko në një postim në "Facebook", shkruan se ky qehet patriotizëm, jo komunizëm, duke shtuar se "e djathta sot është në opozitë jo nga kënga që iu këndojnë kundërshtarët, por nga padija për të kënduar një këngë të vetën". "Opozita ka protestuar pse është dëgjuar në ambientet e një shkolle "kënga e partizanit të vogël Velo"... Kjo është për të qeshur dhe për të ardhur keq. Çfarë të keqe paska kjo këngë dhe kë fyen ajo?! Para pak ko-



hësh, qeveria shqiptare mori vendimin për të rikthyer në atdhe eshtrat e Mithat Frashërit. Asnjë veteran apo familje të lidhura me Luftën nuk protestoi. Pasardhësin e Frashërlinjve me gjithë ndarjet dhe kundërshtitë që vijnë nga historia e

para 1944-ës si ish-kreu i Ballit Kombëtar ata e respektuan si njerëz dhe si shqiptarë dinjitozë. Opozita heshti për këtë vendim. Ajo merret sot me faktin pse këndohet kënga për një partizan që mori armët në moshë të re kundër okupatorit të vendit. "Këshillat e lagjeve"

të dikurshme në kohën e komunizmit të shikonin me kë rrije, si i mbaje flokët dhe çfarë kënge këndoje...". shkroi Majko. "Bravo i goftë asaj shkolle që ka vënë këngë partizane për ditën e parë të shkollës. Ajo është kënga e atyre që rrëmbyen armët kur atdheun ia u pushtuan të huajt. Ky qehet patriotizëm jo komunizëm. Komunizmin nuk ia u sollën partizanët 14-vjeçarë. Shikoni sa ish-partizanë janë burgosur gjatë komunizmit dhe pastaj protestoni. E djathta sot është në opozitë jo nga kënga që iu këndojnë kundërshtarët, por nga padija për të kënduar një këngë të vetën... Sigurisht!", theksoi Majko.

qezë, përbën një akt domethënës jo vetëm për komunitetin katolik të Kosovës, por për mbarë shqiptarët. Presidenti Meta dhe Ati i Shenjtë diskutuan edhe për zhvillimet e fundit në rajonin e Ballkanit dhe rëndësinë e jashtëzakonshme që ka bashkë-

jetesa ndëretnike dhe fetare në dobi të stabilitetit, sigurisë, paqes dhe mirëqenies së popujve tanë për të mos u rikthyer më kurrë në konfliktet e përgjakshme të viteve '90-të. Ati i Shenjtë vlerësoi forcën e shqiptarëve dhe përkushtimin e tyre për t'u ringritur

shpirtërisht pas periudhës së gjatë të shtypjes dhe ndalimit të besimit, nënvizoi arrijtet e deritanishme të Shqipërisë veçanërisht në fushën e lirisë së besimit dhe shprehur mbresat e tij të jashtëzakonshme nga vizita e tij në Shqipëri dhe mikpritja që ju

rezervua gjatë kësaj vizite historike.

Presidenti Meta dhe Ati i Shenjtë diskutuan, gjithashtu, edhe për çështjen e mprehtë të emigracionit, luftën kundër varfërisë, rëndësinë e ruajtjes së ambientit dhe kujdesin ndaj familjes dhe

veçanërisht ndaj gruas dhe fëmijëve, në këndvështrimin e ndërtimit të një shoqërie më njerëzore dhe të një bote në paqe. Ati i Shenjtë dhe Presidenti Meta diskutuan mbi rëndësinë e madhe për të siguruar një të ardhme më të mirë për të rinjtë me qëllim ndalimin e fenomenit të largimit nga vendi i tyre dhe mbajtjes larg nga vëset, droga dhe fenomenet negative sociale. "Europa po përjeton një dimër demografik," - u shpreh Papa Françesku, ndaj vendi juaj duhet të mos vuajë nga ky fenomen, i cili kërkon një përkujdesje, përkushtim dhe vëmendje më të madhe në edukimin, arsimimin dhe krijimin e mundësive më të mira për ta. "Rrallë kam parë", - tha Papa Françesku gjatë audiencës, "aq shumë të rinj gjatë vizitës sime në Tiranë sa në asnjë vend tjetër e duhet bërë gjithçka që ata të qëndrojnë në vendin e tyre". Në vijim të vizitës së tij në Selinë e Shenjtë, Presidenti Meta u takua edhe me Sekretarin e Shtetit të Vatikanit, Kardinalin Pietro Parolin. Presidenti Meta nënvizoi dje, në takim me sekretarin e shtetit të Vatikanit, se të gjithë mirëpresin një marrëveshje mes Serbisë e Kosovës. "Popujt e rajonit tonë kanë vuajtur shumë nga konfliktet etnike ndaj duhet të angazhohemi më shumë për forcimin e bashkëpunimit ndëretnik dhe ndërftetar në rajonin tonë", - tha Presidenti Meta.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHIL.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotaktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk



Darina Tanushi

Dështon protesta e shoqërisë civile kundër aplikimit të tarifës

# Nis pagesa për kalimin në Rrugën e Kombit, Rama: Ndjesë kuksianëve

Kryeministri: Çdo taksë për rrugën do kthehet në investim

## Deputeti i PD-së, Shehaj në Kukës: Policia, terror që të mos protestojnë

Deputeti demokrat Agron Shehaj, ishte dje, në emër të Partisë Demokratike, për të protestuar në Kukës kundër taksës në Rrugën e Kombit. Shehaj akuzoi qeverinë se ka përdorur policinë për të mbytur protestën qytetare, ndërsa demonoi sjelljen e shumicës së mediave, që me heshitjen e tyre mbështetën vjedhjen. Shehaj deklaroi se aleanca krim-qeveri-oligarki-media është rrezik për Shqipërinë dhe të ardhmen tonë dhe sipas tij ka vetëm një shpëtim prej saj: shkatërrimi i saj. Deputeti i PD tha se gjithë natën e kaluar dhe gjithë ditën sot forcat e policisë kanë bërë demonstrim force dhe terror psikologjik ndaj qytetarëve për t'i ndaluar ata të protestojnë. "I gjithë aparat policor dhe shtetëror ishte rreshtuar sot kundër qytetarëve dhe në mbrojtje të vjedhjes për mes koncesionit korruptiv të Rrugës së Kombit. Gjithë natën mbëmë dhe gjithë ditën sot forcat e policisë kanë bërë demonstrim force dhe terror psikologjik ndaj qytetarëve për t'i ndaluar ata të protestojnë. Ndërkohë, mediat kanë heshitur pothuajse të gjitha, ndërsa shumë prej tyre u angazhuan në fushata keqinformuese", u shpreh Shehaj. "Megjithatë, qytetarët dolën në rrugë kundër vjedhjes për pasurinë e Ramës dhe oligarkëve të tij. Në emër të Partisë Demokratike, së bashku me anëtarë dhe drejtues të PD-së, isha atje dhe pashë në veprim shtetin e kapur nga korrupsioni dhe krimi", -tha deputeti i PD-së.

## Zenel Kuçana: Qytetarët e pritën normalisht, 35 sekonda për të kaluar

Prefekti i Kukësit Zenel Kuçana tha se situata dje, në doganën e Morinës ka qenë normale. Gjatë një prononcimi për ATSH, Kuçana tha: "Sot, (dje) nisi dhe tarifi i Rrugës së Kombit dhe kjo u prit normalisht nga qytetarët, që ishin të informuar saktësisht mbi tarifën dhe mënyrën se si duhej të vepronin për të kaluar pikat e tarifave. Dua të theksoj se një qytetari i duhur vetëm 35 sekonda për të kaluar në pikën tarifore dhe kjo është mjaft pozitive, pasi nuk humbin kohë. Targat e Kukësit janë të regjistruara dhe kjo rrit edhe më tej shpejtësinë për qytetarët vendas, të cilët kanë dhe tarifën prej 100 lekësh të reja". Prefekti i Kukësit shtoi se banorët nuk ranë pre e provokimeve. "Sot ishin mbledhur nga 10 vetë për të protestuar për tarifën me në krye një aktivist, por banorët e Kukësit nuk iu bashkuan kësaj nisme, e cila ishte e pakuptimtë, pasi banorët e kanë të qartë tashmë rëndësinë e këtij tarifi", - tha Kuçana.

Nisi dje, zbatimi i tarifës për kalimin në Rrugën e Kombit. Ashtu sikurse ishte paralajmëruar nga kompania koncesionare dhe qeveria, të gjithë ata që kaluan të hënën në këtë rrugë iu në shtruan taksës, sipas kategorive të përcaktuara. Ndryshe edhe nga sa ishte paralajmëruar nga shoqëria civile se aplikimi i taksës do të pritej dje, me protesta në Morinë, nuk pati probleme. Përfaqësues të shoqërisë civile u nisën dje nga Tirana për t'u bashkuar qytetarëve të Kukësit për një protestë të fuqishme, por kjo rezultoi e dështuar. Përveç disa qytetarëve të Kukësit dhe disa përfaqësuesve të shoqërisë civile, askush tjetër nuk shkoi në qendër të qytetit në orën 11.00, ku do të protestohet kundër taksës në fjalë. Në një lidhje direkte për 'News24' nga Kukësi, gazetari Erjon Skëndaj pohoi se në shesh pati një prani të vogël qytetarësh. Sipas tij në protestë ishte vetëm kryetari i PD-së dhe ish-kryetari për Kukësin, ndërsa u vu re mungesa e kryetarit të bashkisë dhe këshilltarëve bashkiakë. I vetmi nga deputetët e PD ishte Agron Shehaj, që i përket qarkut të Vlorës, ndërsa u vu re mungesa e kolegut të tij Flamur Noka. Pjesëmarrësit në protestë thanë se shkak i mospjesëmarrjes në tubim të qytetarëve të Kukësit ka qenë frika dhe presionet e ushtruara ndaj tyre. Ndërkaj pranë tunelit kishte prezencë të forcave të mëdha të FNSH-së, për të parandaluar kështu çdo skenar të mundshëm. Në mesin e ditës së djeshme, kryeministri Edi Rama vendosi të falënderonte qytetarët kuksianë. Në një postim në 'Twitter' Rama shpreh falënderime për qytetarët e Kukësit, për mirëkuptimin e qytetarëve e treguar, shkruan kreu i qeverisë. "Faleminderit kuksianëve për mirëkuptimin e qytetarëve. Dhe njëherë ndjesë për shqetësimin e krijuar. Do bëjmë çmos që jo vetëm çdo qindarkë për rrugën të kthehet në investim, po dhe që Kukësi të bëhet shpejt me aeroport e të ketë më shumë investime



Sportletet në Rrugën e Kombit

### MASAT E POLICISE

"Nga Miloti deri në Kukës ka pasur masa të shtuara policie. Policia rrugore ishte vendosur në të gjitha kryqëzimet kryesore. Nga sa është vënë re nga media gjatë autostradës në disa karburante kanë qenë të vendosur Forcat Speciale dhe FNSH për të ndërrhyrë në rast të ndonjë acarimi situatë. Edhe në Kukës ka pasur forca shtesë të policisë, por dje nuk ka pasur asnjë acarim të situatës, me gjithë paralajmërimet e shoqërisë civile. Drejtuesit e policisë së Kukësit nuk kanë pasur asnjë kërkesë zyrtare për të marrë leje për protestën.

### PAGESAT PËR KALIMIN E RRUGËS NGA DISA KATEGORI:

- Tarifa për kalimin e automjeteve në autostradën Milot-Morinë do të jetë 660 lekë (ose 5 euro).
- Për banorët e qarkut Kukës kjo tarifë është e reduktuar në 100 lekë me TVSH.
- Për çdo kalim deri në 44 kalime tarifa është 100 lekë, përfshirë edhe TVSH-në.
- Tarifat variojnë sipas llojit të mjetit; motoçikletat dhe automjete me tre rrota do të paguajnë 330 lekë, përjashtim bëjnë banorët e qarkut Kukës, të cilët do ta kenë tarifën 50 lekë.
- Automjete komerciale me dy akse dhe 6 rrota (1.90 m dhe 2.70 m) do të paguajnë 1490 lekë.
- Kamionët të mesëm dhe autobusët të rëndë, përfshirë mjete me lartësi 2.7 m do të paguajnë 2140 lekë.
- Kamionët të rëndë 4 akse a më shumë, do të paguajnë 2970 lekë.
- Përdoruesit e shpeshitë të kësaj rruge do të përfitojnë reduktime të ndjeshme të tarifimit.
- Për 20-30 kalime në muaj, përfitojnë 10% zbritje
- Për 30-50 kalime në muaj përfitojnë 20% zbritje
- Për 50-60 kalime në muaj përfitojnë 30% zbritje dhe mbi 60 kalime përfitojnë 40% zbritje.

e punësim real, plus stadium të ri" - shkroi dje, Rama. Kështu për automjetet 4+1 tarifa e kalimit është 5 euro apo 660 lekë. Biçikletat dhe automjetet me 3 rrota do të paguajnë 330 lekë kurse automjetet komerciale me dy akse dhe 6 rrota (furgonë) 1490 lekë. Kamionët e mesëm dhe autobusët e rëndë përfshirë mjetet me lartësi 2.7 metra do të paguajnë 2140 lekë dhe kategoria e fundit kamionët e rëndë me katër akse apo më shumë do të paguajnë 2970 lekë. Pavarësisht çmimeve standarde kompania koncesionare dhe qeveria negociuan edhe një grup të ri tarifash për ata që u quajtën përdorues të shpeshitë të rrugës. Kjo u pa

e nevojshme në kushtet kur banorët e Kukësit e kundërshtuan masivisht tarifën në Milot-Morinë, diçka që u përkallëzua deri në djegjen e stacionit të pagesës. Në 4 shtator të këtij viti qeveria miratoi vendimin që sanksiononte se cilët do të quhen përdorues të shpeshitë dhe lehtësia që do të përfitojnë ata në këtë tarifën. **TARIFAT PËR PËRDORUESIT E SHPESHITË TË RRUGËS** Tre janë kategoritë që cilësohen si 'përdorues të shpeshitë të rrugës' ku së pari, automjetet e banorëve të qarkut Kukës, së dyti, autobusët nga dhe për në qarkun e Kukësit dhe së treti automje-

tet e përdoruesve të shpeshitë. Në kategorinë e parë të automjeteve të banorëve të qarkut Kukës përfshihen klasat A e B të automjeteve për përdorim personal të regjistruara në qarkun Kukës. Këto automjete do të pajisen me OBU-në (On Board Unit) e sistemit Digital Pass dhe në OBU nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete për familje. Tarifa e rrugës për 1 (një) kalim për të gjitha automjetet e regjistruara në qarkun Kukës për klasën A (motoçikletë) do të jetë 50 (pesëdhjetë) lekë me TVSH dhe për automjetet e klasës B (automjetet 4+1)do të jetë 100 (njëqind) lekë me TVSH. Kjo tarifë do të jetë e kufizuar për jo më shumë se 44 (dyzet e katër) kalime në muaj dhe e vlefshme për t'u përdorur brenda periudhës 1-mujore nga data e kryerjes së pagesës për këto kalime. Nëse tejkalohet numri i tarifimit pas kalimit të 44 nis me tarifën normale 5 euro. Në kategorinë e dytë përfshihen autobusët nga dhe për në qarkun e Kukësit. Tarifa e rrugës për këta autobusë do të jetë 100 (njëqind) lekë me TVSH për 1 (një) kalim. Në kategorinë e tretë përfshihen përdoruesit e shpeshitë të autostradës Milot-Morinë, automjetet e të cilëve do të pajisen me OBU-në (kostoja e OBU-së do të përballohet nga këta përdorues të shpeshitë të autostradës) dhe nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete. Lidhur me kategorinë "Përdorues të shpeshitë", pa dallim mjeti, ulja e tarifës do të bëhet për numër kalimesh, pasi sistemi do të funksionojë në mënyrë të tillë që do të regjistrojë numrin e kalimeve për çdo mjet.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Zyra përmbartore "Best 2019"

SHPLLALJE ANKANDI

Më datë 16 tetor 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përmbartore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shijën e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK.8603, me cmin fillistar 3307500 lekë; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me cmin fillistar 2515600 lekë

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIS J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692705 644







Krimet e Rënda në pritje të letërporosive të dërguara në drejtim të Italisë dhe Greqisë

# Mali i Zi konfirmon udhëtimin me jaht të Tahirit drejt Italisë

## Thirren në pyetje personat që udhëtuan me ish-ministrin

Mali i Zi kthen përgjigje për udhëtimin me jaht të ish-ministrit. Pas letërporosisë dërguar autoriteteve malazeze për dosjen "Habilaj", prokuroria ka në dorë përgjigjen. Shteti fqinj ka sjellë përgjigjen e letërporosisë tek prokurorëve për Krimet e Rënda iu ka mbetur edhe një muaj afat për të vendosur për fatin e ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahirit. Përmes letërporosisë autoritetet malazeze i konfirmojnë prokurorisë shqiptare një udhëtim me jaht të Tahirit nga vendi i tyre drejt Italisë, verën e 2017, i cili ka kaluar edhe në brigjet bregdetare të Malit të Zi. Dokumenti po përkethehet në zyrat e Ministrisë së Drejtësisë dhe do t'i bashkëngjitet fashikullit të hetimit. Në dokument thuhet se jahti, është në pronësi të një shtetasi shqiptar, identiteti i të cilit mbahet tejet sekret nga prokurorët.

Mësohet se autoritetet e huaja kanë përcjellë edhe të dhëna të tjera, që lidhen me këtë udhëtim, që nga orari i nisjes, flamuri që mbante jahti, dhe emrat e personave që shoqëronin ish-ministrin e Brendshëm. Pas marrjes së këtij dokumenti pesë prokurorët e çështjes kanë firmosur letërkopjet në emër të të gjithë personave që janë gjendur në sho-



qërinë e ish-zyrtarit të lartë, të cilët pritet të paraqiten përgjatë kësaj jave për të

dhënë shpjegimet e tyre. Gjithashtu, organi i akuzës është në pritje të letërporosive

të dërguara më herët në drejtim të Italisë dhe Greqisë. Më konkretisht, grupi i hetimit i ka kërkuar palës italiane t'u vendosë në dispozicion dëshmitë e anëtarëve të dosjes "Habilaj", të arrestuar me urdhër të gjykatës së Katantias, si pjesë e një grupi narkotrafiku. Sipas burimeve, ndër dëshmitë e kërkuara janë edhe ato të Moisi Habilajt, i dyshuar të grupit kriminal, si edhe të Nezar Seitit, i cili u arrestua në Shqipëri.

### LETËRPOROSIA


Përmes letërporosisë autoritetet malazeze i konfirmojnë prokurorisë shqiptare një udhëtim me jaht të Tahirit nga vendi i tyre drejt Italisë, verën e 2017, i cili ka kaluar edhe në brigjet bregdetare të Malit të Zi. Dokumenti po përkethehet në zyrat e Ministrisë së Drejtësisë dhe do t'i bashkëngjitet fashikullit të hetimit.

prokuroria e krimeve të rënda çeli hetim ndaj ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, me dyshimet për përfshirje në grupin e kushërinjve të tij. Së fundmi, Saimir Tahiri po qëndron në heshtje. Që prej tetorit 2017, kur ndaj tij prokuroria çeli hetimin pas dyshimeve për lidhje me grupin kriminal "Habilaj", ish-ministri ka dalë triumfator përballë drejtësisë. Ai mundi të shpëtojte nga arrestimi, pasi Kuvendi nuk i dha autorizim prokurorisë. Ndërsa ka dalë fitues në dy betejat e zhvilluara në gjykata. Herën e parë ai e bindi Apelin për Krimet e Rënda t'i kthente pasaportën, e në përballjen e dytë ta lironte nga arresti i shtëpisë.

Në muajin maj Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda shfuqizoi masën e sigurisë arrest-shtëpie për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Pas dy orësh e gjysmë seancë, Apeli i Krimeve të Rënda rrëzoi masën e vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë ndaj ish-ministrit, duke e lënë atë të lirë. Ish-ministri dyshohet se ka shpërdoruar detyrën dhe ka kryer korrupsion në kuadër të grupit të strukturuar kriminal të drejtuar nga Moisi Habilaj i përfshirë në trafikun e kanabisit nga Shqipëria drejt Italisë.

### HETIMET

Vetëm një muaj pasi Saimir Tahiri u shkarkua si ministër i Brendshëm dhe drejtimin e këtij dikasteri e mori Fatmir Xhafaj, policia i vu në ndjekje të Habilajve. Ishin blutë e Vlorës që në prill 2017, i çuan materialin e parë Prokurorisë për Krimet e Rënda, për vëllezërit Moisi e Florian Habilaj dhe disa persona të tjerë, të dyshuar si pjesëtarë të një grupi kriminal në fushën e trafikut të drogës. Vetëm pas arrestimit të Moisi Habilajt në Itali



REPUBLICA E SHQIPËRISË

## GJYKATA KUSHTETUESE

### KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

#### SHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese (KPA), bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatës dhe Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organcës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit".

**I - Shpall vendin vakant për pozicionin "Specialist Sekretarë Gjyqësorë"**

Kandidatit duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

**KUSHTET PËR GJITHSHMË**

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për t'u pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë afësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20 Shtator 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator 2018 në adresën: info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

**Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:**

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën e diplomave, sipas legjislativës në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimin, kualifikimin, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

## Nën akuzë për korrupsion, prokuroria kërkon 4 vjet burg për gjykatësin Shkëlqim Miri

Prokuroria për Krimet e Rënda ka lexuar ditën e djeshme pretendencën për gjykatësin e Apelit Tiranë, Shkëlqim Miri. Organi i akuzës kërkoi dënimin me 4 vjet burg për gjykatësin, i cili akuzohet për korrupsion. Gjyqtari i Apelit Tiranë, u ndalua në kuadër të operacionit policor "Një vrasje e dytë". Ai akuzohet për veprën penale të korrupsionit të funksionarëve të drejtësisë. Shkëlqim Miri dyshohet se favorizoi të dënuarin Gentian Doda duke i ndryshuar akuzën nga vrasje me paramendim në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen, kundrejt një shume të konsideruar parash. Prokuroria për Krimet e Rënda thotë se ka prova të mjaftueshme që e implikojnë gjykatësin në skemën korruptive. Si dënim



plotësues, prokurori Klodian Braho kërkoi që gjykatësit të Apelit t'i hiqej e drejta për të ushtruar profesionin për periudhën prej tri vjetësh. Gjithashtu, u kërkua që të pandehurit t'i konfiskohet shuma prej 30 mijë eurosh, me argumentin se është provuar që këto para janë marrë rryshfet për vendimin favorizues për të dënuarin Doda. Pjesa tjetër e shumës prej 30 milionë lekësh, që iu gjetën në shtëpi

gjykatësit nëntorin e 2017, kur edhe u vu në pranga u kërkua nga prokuroria që t'i kthehet të pandehurit, por për burimin e parave, po zhvillohet një hetim pasuror sipas ligjit antimafia. Për të pandehurin Kujtim Miri, i dyshuar për korrupsion, u kërkua dënimin me 2 vjet e gjashtë muaj burg. Kushëriri i gjykatësit dyshohet se ka pasur rolin e ndërmjetësit. Të dy të pandehurit përfitojnë ulje të një të tretës së dënim-it, për shkak të gjykimit të shkurtuar. Në ngjarje rezultoi të jetë i përfshirë edhe Alban Buci, i shpallur në kërkim. Sipas prokurorisë, ai është personi që ka ndërmjetësuar dhe dorëzuar paratë e rryshfetit, duke mundësuar edhe lirinë e mikut të tij, Gentian Doda.

## DITA E PARË E SHKOLLËS

### URIMET DHE DENONCIMET

9-vjeçarja "Dora d'Istria" fillon mësimin, kushte moderne dhe ambiente të rikonstruara

# Nis viti i ri shkollor për 480 mijë nxënës të arsimit parauniversitar

*Gjimnazistët pro dhe kundër ndalimit të celularit*

Voltiza Duro

**D**je ka nisur viti i ri shkollor 2018-2019, për 480 mijë nxënës të arsimit parauniversitar në mbarë vendin. Ndërkohë rreth 32 mijë vogëlushë janë ulur për herë të parë në bankat e shkollës. "Gazeta Shqiptare" dje në ambientet e shkollës 9 vjeçare "Dora d'Istria" në kryeqytet ndoqi nga afër ditën e parë të vitit mësimor. Nxënësit e klasave të para plot emocion po prisnin zilen e parë për të nisur mësimin. "Sot (dje) filloj klasën e parë. Do të mësoj shumë dhe do të kem shoqe të reja. Shkolla është shumë e bukur, më pëlgen shumë", thotë plot emocion një prej vogëlusheve të klasës së parë. Vetë prindërit vlerësojnë nisimën e qeverisë për shpërndarjen e teksteve shkollore falas për nxënësit nga klasa e parë deri në të katërt. "Është një nisim për t'u vlerësuar, sidomos për familjet që nuk kanë mundësi ekonomike që t'i blejnë. Fakti që do t'i kthejnë sërish rrit më shumë përgjegjësinë të fëmijëve për të mos i shkarravitur apo grisur librat", tregon për "GSH" nëna e një nxënësi në klasën e tretë të kësaj shkolle. Ndërkohë, bazuar në statistika, vihet re se këtë vit të ri shkollor numri i nxënësve të arsimit parauniversitar është ulur me 15 mijë nxënës më pak. Një rënie e numrit të fëmijëve konstatohet edhe të klasat e para, nga 33 mijë në vitin e kaluar në 32 mijë këtë vit.

#### GJIMNAZET

Edhe shkollat e mesme në vend kanë nisur ditën e djeshme vitin e ri mësimor 2018-2019. "Gazeta Shqiptare" ndodhej dje në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" në kryeqytet ku ndoqi nga afër këtë ditë të veçantë për nxënësit. Ndërkohë këtë vit rreth 39 mijë maturantë do të ulen në bankat e shkollës për të finalizuar arsimin parauniversitar me provimet e Maturës Shtetërore. Për sa i përket vendimit të qeverisë për ndalimin e aparateve celulare në orën e mësimi, vetë nxënësit kanë opinionet të ndryshme lidhur me këtë. "Është një vendim



Dita e parë e shkollës në 9 vjeçaren "Dora d'Istria"

#### VELIAJ LETËR NXËNËSVE: "MUND TË KALONI SFIDAT"

Nxënësit e shkollave të Tiranës kanë marrë edhe një letër frymëzuese e me këshilla nga kryebashkiaku Erion Veliaj, përmes së cilës ai u uron suksese për vitin e shkollor. Veliaj thotë se çdo vit i ri është një mundësi për t'i treguar vetes, familjarëve e miqve se me dëshirë e vullnet mund të kalojë çdo sfidë. "Urime për vitin e ri shkollor, ty dhe 70,000 shokëve e shoqeve, të cilët sot kanë nisur ditën e parë të shkollës në Tiranë. Çdo vit i ri është një mundësi për t'i treguar vetes, familjarëve e miqve se me dëshirë e vullnet mund të kaloni çdo sfidë. Por, mos harroni asnjëherë se edukimi i zëmërës është po aq i rëndësishëm sa edhe mprehtësimi i mendjes", - shkruan Veliaj. Ky i fundit shton se shumë shpejt Tiranës do t'i shtohen edhe 17 shkollat të reja, duke sjellë kushte më të mira e të përshtatshme për nxënësit.



shumë efektive. Do të jemi më të përqendruar në orën e mësimi dhe kështu do të mësojmë më shumë. Telefoni shpeshherë të shpërqendron, kështu është më mirë që nuk do e përdorim", tregon maturantja e gjimnazit Sami Frashëri. Ndërkohë

ka dhe nga ata gjimnazistë që mendojnë se aparati celular është i domosdoshëm. "Nuk jam dhe aq pro heqjes së aparateve celulare. Kush është i përqendruar gjatë mësimi e di që nuk duhet të prekë telefonin apo të luajë me të. Por mund të kemi

#### ARBEN AHMETAJ: "SHKOLLA PROFESIONALE, ZGJEDHJE E DUHUR"

Në ditën e parë të vitit shkollor ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ishte në shkollën profesionale të rikonstruktuar të Kamzës, një investim në vlerën 213 milionë lekë nga buxheti i shtetit, në të cilën studiojnë mbi 1800 nxënës në disa drejtime si IT, shërbim social, hoteleri turizëm, bujqësi etj. Në fjalën e tij ministri Ahmetaj, tha se shifrat e arsimit profesional kanë ardhur në rritje në vitet e fundit dhe i njëjti trend vërehet nga sistemi i gjurmimit, edhe për punësimin pas përfundimit të shkollës. Ahmetaj tha se formimi profesional është një zgjedhje e duhur, që afron garancitë për punësimin. "Sot janë 76 mijë të papunë të regjistruar, ndërkohë në anën tjetër janë 46 mijë vende pune të lira", -tha Ahmetaj.



një emergjencë dhe normalisht është mjet komunikimi me familjarët apo miqtë. S'jam dakord që u ndalua përdorimi i tij", -thotë një nxënësi i "Sami Frashërit". Ndërkohë në udhëzimin e përbashkët të MASR bëhet me dije se mësimi për ar-



## Edi Rama: Projekti për 17 shkollat e reja

Projektet i 17 shkollave të reja në kryeqytet është në fazën finale të fillimit të zbatimit të kontratave. Lajmin e ka bërë të ditur kryeministri, Edi Rama, gjatë inaugurimit të shkollës së re 'Kosova', të cilën e cilësoi edhe shkollën simbol të historisë së Tiranës. "Më vjen shumë mirë që brenda pak javësh, së bashku me Bashkinë e Tiranës, ne do të fillojmë projektin e madh të 17 shkollave të reja. Janë 17 shkolla që do të financohen nga programi "1 miliard për rindërtim" i qeverisë dhe janë 17 shkolla që tanimë janë në fazën finale të fillimit të zbatimit të kontratave, të projektuara nga arkitektë të mëdhenj, të huaj dhe që do të jenë në vazhdim e kësaj pamjeje dhe të kësaj cilësie të re për shkollat ku shkojnë fëmijët tanë", -u shpreh Rama. Në mbyllje të fjalës së tij, Rama uroi të gjithë mësuesit, prindërit dhe nxënësit për një vit të mbarë e të suksesshëm shkollor.



## PD denoncon mbylljen e 150 shkollave në vend

Fillimi i vitit të ri shkollor ka nisur me probleme në pjesën më të madhe të qyteteve dhe fshatrave të vendit. Dje, Partia Demokratike ka zbuluar në terren dhe ka denoncur mbylljen e shkollave në qytete të ndryshme të vendit. Deputetët e kësaj partie, nga vende të ndryshme kanë denoncur mbylljen e shkollave, por edhe gjendjen skandalozë të tyre. Denoncimet e Partisë Demokratike vijnë nga qytetet të ndryshme, ndërsa së bashku me këtë, deputetët e kësaj partie japin shifra për numrin e shkollave, të cilat janë mbyllur. Partia Demokratike thekson se "Rilindja" për këtë vit të ri shkollor iu ka mbyllur shqiptarëve 133 shkolla në të gjithë vendin. Në reagimet e tyre, ata bëjnë përgjegjës direkt kryeministrin dhe qeverinë e tij. Deputetja e Partisë Demokratike, Izmira Ullinaku denoncon se shkolla 9-vjeçare në fshatin Samrisht të Dajcit në Shkodër është mbyllur. Edhe deputetja e PD-së, Albana Vokshi, tha se janë mbyllur rreth 150 shkolla nga qeveria e Ramës. Sipas saj, nuk është e vërtetë ajo që thotë qeveria se janë mbyllur shkolla kolektive, por shton se janë mbyllur ato që mbarin histori. Gjithashtu, ajo deklaroi se shkollat janë mbyllur nga ferrat dhe shkurret, ku thekson se kjo panoramë ka zëvendësuar buzëqeshjen e fëmijëve.

simin bazë do të përfundojë më 12 qershor të 2019-ës. Pushimet e dimrit do të fillojnë në 22 dhjetor dhe do të përfundojnë në 6 janar 2019. "Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 13-30 qershor 2019. Rregullorja e zhvillimit të

provimeve kombëtare të arsimit bazë 2019 dhe udhëzimet përkatëse do të miratohen nga ministri", -theksohet në udhëzim. Në këtë të fundit bëhet me dije, gjithashtu, se për maturat viti shkollor do të përfundojë në 4 qershor.





Reason MASR: Kallëzimi, në vitet 2012-2013. Jemi në mbështetje të organeve ligjzbatuese

# Regjistrime fiktive të nxënësve në klasa, gjykata pezullon 16 mësues

## Prokuroria: Akuzohen për "Shpërdorim detyre" dhe "Falsifikim i dokumenteve shkollore"

LUSHNJE

Gjykata e Lushnjës ka pranuar kërkesën e prokurorisë së rrethit për pezullimin nga detyra të 16 mësuesve të shkollës 9-vjeçare në Çermë të Divjakës. Ata nuk janë lejuar të ushtrjnë profesionin e tyre në ditën e parë të shkollës, pasi akuzohen për shpërdorim detyre dhe falsifikim të dokumenteve shkollore. Burime zyrtare nga organi i akuzës dje bënë me dije se kërkesa për pezullim është bërë regjistrimi fiktiv i nxënësve në këtë shkollë me qëllim që të mos mbylleshin klasat. Organi i akuzës ka provuar se në klasat ku është kërkuar pezullimi i mësuesve nga 13 nxënës që ishin normalisht, ishin regjistruar 16 apo 17 të tillë. Mësohet se mësuesit e pezulluar, në bashkëpunim me njëri-tjetrin falsifikonin numrin e amzës dhe pajisnin me dëftesa persona, të cilët nuk frekuentonin shkollën. "Gjykata e Lushnjës pranoi kërkesën e prokurorisë së Lushnjës, me vendim nr 119 datë 13.09.2018, për pezullimin nga detyra të 16 mësuesve të shkollës 9-vjeçare Çermë e Sipërme-Divjake rrethi Lushnje. Për ta ka regjistruar si persona nën hetim me akuzat: Shpërdorim detyre dhe falsifikim i dokumenteve shkollore, mbështetur në nenet 248 e 187 të Kodit Penal. Procedimi penal me nr. 400 viti 2017. Komunikimi i masës është kryer me datë 14.09.2018", -thuhet në njoftimin zyrtar të prokurorisë.



9-vjeçare në Çermë të Divjakës

AKUZAT

"Gjykata Lushnje pranoi kërkesën e prokurorisë së Lushnjës, me vendim nr 119 datë 13.09.2018, për pezullimin nga detyra të 16 mësuesve të shkollës 9-vjeçare Çermë e Sipërme-Divjake rrethi Lushnje. Për ta ka regjistruar si persona nën hetim me akuzat: Shpërdorim detyre dhe falsifikim i dokumenteve shkollore, mbështetur në nenet 248 e 187 të Kodit Penal. Procedimi penal me nr. 400 viti 2017. Komunikimi i masës është kryer me datë 14.09.2018", -thuhet në njoftimin zyrtar të prokurorisë.

HETIMI

"Bazuar në kallëzimin e bërë gjatë viteve 2010-2013 se në shkollën 9-vjeçare Çermë e Sipërme ka pasur regjistrime fiktive, prokuroria e Lushnjës ka regjistruar procedimin penal për "Falsifikimin e dokumenteve shkollore". Prokuroria e Lushnjës ka filluar hetimet prej disa kohësh për këtë rast duke kërkuar sot nga gjykata pezullimin e 16 mësuesve. Ky vendim është zbatuar menjëherë nga Zyra Arsimore Lushnje duke marrë masa të menjëhershme për zëvendësimin e këtyre mësuesve dhe mos pasur asnjë pengesë për mbarëvajtjen mësimore", -sqaroi MASR.



REAGIMI I MASR

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me prokurorinë e Lushnjës ka ndjekur me seriozitet situatën deri në pezullimin e 16 mësuesve në shkollën 9-vjeçare të fshatit Çermë e Sipërme në Lushnje. Ky vendim është zbatuar menjëherë nga Zyra Arsimore Lushnje duke marrë masa të menjëhershme për zëvendësimin e këtyre mësuesve dhe mos pasur asnjë pengesë për mbarëvajtjen mësimore.

SQAROJMË OPINIONIN PUBLIK SE

Bazuar në kallëzimin e bërë gjatë viteve 2010-2013 se në shkollën 9-vjeçare Çermë

e Sipërme ka pasur regjistrime fiktive, prokuroria e Lushnjës ka regjistruar procedimin penal për "Falsifikimin e dokumenteve shkollore". Prokuroria e Lushnjës ka filluar hetimet prej disa kohësh për këtë rast duke kërkuar sot nga gjykata pezullimin e 16 mësuesve. Ky vendim është zbatuar menjëherë nga Zyra Arsimore Lushnje duke marrë masa të menjëhershme për zëvendësimin e këtyre mësuesve dhe mos pasur asnjë pengesë për mbarëvajtjen mësimore.

Ministria e Arsimit mbështet vijimin e hetimit nga organet ligjzbatuese dhe siguron se për nxënësit e shkollës nuk do të ketë asnjë pengesë për të vijuar normalisht procesin mësimor. Pfojmë prindërit, mësuesit dhe nxënësit të denoncojnë çdo shkelje apo parregullsi të konstatuar në sistemin tonë arsimor.

SHKURTE

Humb jetën punëtori i mirëmbajtjes së rrugës

**LIBRAZHËD** - Një i ri ka humbur jetën tragjikisht në Librazhd. Mësohet se 24-vjeçari me initiale D.L., banues në Pogradec, punëtor i mirëmbajtjes së rrugës, ka mbërritur në spital pa shenja jete. Policia dje bëri me dije se dyshohet se i riu ka rënë në kontakt me energjinë elektrike, por ende nuk është përcaktuar saktësisht shkaku i vdekjes. "Në spitalin e Librazhdit është dërguar pa shenja jete shtetasi D.L., 24 vjeç, banues në Pogradec, i cili ishte punëtor i mirëmbajtjes së rrugës, ku gjatë punës në fshatin Xhyrë, Librazhd, dyshohet se ka rënë në kontakt me energjinë elektrike dhe si pasojë ka gjetur vdekjen", deklaroi zyrtarisht policia. Grupi hetimor po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, por paraprakisht dyshohet se ngjarja është aksidentale", -thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Në aksin Librazhd-Përrenjas janë duke u kryer punime nga ARRSH, konkretisht në fshatin Xhyrë të Njësisë Administrative Hotolisht, aktualisht janë duke u kryer punime në një segment ku ka pasur dëmtime të rrugës si pasojë e rrëshqitjes së tokës. Për këtë arsye dyshohet se 24-vjeçari ka rënë aksidentalisht në kontakt me rrjetin elektrik nën-tokë.

Misteri, përfundojnë në spital dy naftëtarët

**DELVINË** - Dy punonjës të një kompanie naftë në Delvinë kanë përfunduar në spital në rrethana ende misterioze. Sipas njoftimit të policisë lokale, ngjarja ka ndodhur dje kur gjatë punës në pusët e naftës të një kompanie, shtetasi H.M., 62 vjeç dhe M.P., 26 vjeç, banues në Patos, Fier, nuk janë ndjerë mirë nga ana shëndetësore. Ata janë shpërndarë në spital për ndihmë mjekësore. Nuk dihet ende se çfarë komplikimesh kanë shfaqur dy punonjësit që punonin në pusët e naftës jashtë qytetit të Delvinës prej disa muajsh. Policia ka nisur hetimet dhe po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

Plagosja e 77-vjeçarit në Lushnje, SHÇBA nis verifikimet

**LUSHNJE** - Pak ditë pas plagosjes me plumb në kokë të 77-vjeçarit Haxhi Lika gjatë operacionit të RENEA-s për kapjen e dy personave të kërkuar për vrasje, SHÇBA ka nisur verifikimet për veprimet e policisë. Sipas bluve, të shumëkërkuarit Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili dyshohej se fshihej pikërisht në banesën e Haxhi Likës. Nga ana e saj, Policia e Shtetit sqaroi ngjarjen duke theksuar se i moshuari nuk iu përgjigj thirrjes së efektiveve, ndërsa mbeti i lënduar në rrethana të paqarta, duke përfunduar me një plagë të rëndë në kokë. Ende nuk është e qartë nëse Haxhiu dhe Bilbili strehoheshin në shtëpinë e 77-vjeçarit. Ky i fundit dhe familjarët e tij deklaruan për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se nuk i njohin dy personat në fjalë dhe se nuk kanë strehuar kriminelë në banesën e tyre. Ata u shprehën se policia i ka terrorizuar në orët e natës. Dy djemtë dhe bashkëshortja e të plagosurit si dhe vetë ky i fundit kërkojnë drejtësi. Gjithashtu, ka dyshime se operacioni i policisë është dekonspiruar dhe mendohet se Laert Haxhiu është larguar nga fshati Remas disa orë përpara se aty të zbarkonte RENEA.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 6.800.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 01.10.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



**Policia: Dyshohet për konflikt të çastit**

**Plagosi me breshëri automatiku 3 persona, përfundon në pranga 32-vjeçari Gegë Gega**

**KURBIN** - Tre persona janë plagosur me armë zjarri në Laç. Ngjarja e rëndë, e cila ka shkaktuar panik të kalimtarët dhe banorët e këtij qyteti ndodhi pasditen e djeshme, rreth orës 17:02, në lagjen "Sanxhak" të këtij qyteti, pranë një pike karburanti. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se 32-vjeçari Gegë Gega ka hapur zjarr me automatik dhe për pasojë ka plagosur shtetasit: Islam Shafloqi, Bajram Shafloqi dhe Gazmir Shafloqi. Tre

kushërinjtë u transportuan urgjentisht drejt Spitalit të Traumës në Tiranë, ku ndodhen nën kujdesin e mjekëve. Në spital, përfundoi edhe autori i ngjarjes, pasi gjatë konfliktit fizik ka pësuar, gjithashtu, lëndime. Ai është arrestuar pikërisht në ambientet ku po merr mjekim. Pas sinjalizimit për plagosjen e trefishtë, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Mësohet se fillimisht Gegë Gega fillimisht është përplasur fizikisht me tre kushërinjtë Shaflo-



qi, të cilët e kanë goditur me sende të forta. Më pas, 32-vjeçari ka marrë automatikun dhe ka qëlluar në drejtim të tyre duke i plagosur Nderkaq, policia sekuestroi automatikun e përdorur nga autori i dyshuar. Zyrtarisht mësohet se gjithçka ndodhi pas një shërri të momentit mes palëve, për shkakë ende të paqarta. Hetuesit e çështjes po hetojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

**Përfundon dënimin, lirohet nga burgu Ermal Hoxha**

**TIRANË**- Lirohet Ermal Hoxha. Mësohet se nipi i ish-diktatorit i dënuar për trafik droge pas zbulimit të laboratorit të kokainës në Xibrakë, ka përfunduar dënimin. Ermal Hoxha u arrestua gjatë operacionit në Xibrakë dhe u dënua me 6 vjet e 8 muaj burg për trafik narkotikësh mbetur në tentativë. Në Xibrakë u zbulua një laborator i sofistikuar përpunimi kokaine. Në prill të këtij viti nipi i ish-diktatorit Enver Hoxha, kërkoi të shpallej i pafajshëm, duke i bërë rekurs vendimit të Apelit të Krimeve të Rënda në Gjykatën e Lartë. Ermal Hoxha bashkë me tetë të pandehurit e dosjes, përfshi edhe dy shtetas kolumbianë, u deklaruan fajtorë nga Krimet e Rënda dhe u dënuan me 104 vjet burg në total. Në nëntor 2017, Apeli i Krimeve u li ndeshëm dënimit e dhëna ndaj tyre, pasi pranoi zbatimin e gjykimit të shkurtuar, duke i ulur çdo të pandehuri një të tretën e masës së dënimit.



Vrasja e trefishtë, humbën jetën Mentor Lufi, Besnik Sulku dhe Gerti Goxhaj

**Masakra te "Zogu I", prokuroria: Burg përjetë për Salvatore Letizia**

*52 vite heqje lirie për Markeljan e Klejvi Doçi*

**P**rokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar burgim të përjetshëm, për shtetasin italian Salvatore Letizia, si një nga autorët e masakrës me tri viktimë të ndodhur në bulevardin "Zogu I", në Tiranë, në vitin 2015. Po ashtu është kërkuar dënimi me 32 vite burg i Markeljan Doçit dhe 20 vite për Klejvi Doçin si bashkëpunëtorë në vrasje. Në masakrën pranë maternitetit të vjetër, mbetën të vrarë Mentor Lufi, Besnik Sulku dhe Gerti Goxhaj. Pretenca u lexua ditën e djeshme gjatë seancës gjyqësore të Krimit e Rënda. Dy vëllezërit Doçi dhe Letizia akuzohen se kanë kryer veprime aktive në konfliktin e armatosur ku mbetën të vdekur shtetasit Mentor Lufi (Doçi), Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku.



Masakra te "Zogu I"



Salvatore Letizia

**MASAKRA TE "ZOGU I"**

Pasditen e datës 27 maj 2015, Mentor Lufi, dy nipat e tij Markeljan e Klejvi Doçi, si edhe miku i tyre, Gerti Goxhaj, gjendeshin në një lokal pranë Fakultetit të Shkenca, në bulevardin "Zogu I" në Tiranë.

Pasi janë ngritur nga lokali, ata kanë hipur në dy mjete dhe konkretisht: Mentor Lufi ishte pasagjer në mjetin e drejtuar nga Gerti Goxhaj; ndërsa vëllezërit Markeljan dhe Klejvi Doçi gjendeshin në një automjet pas të parit, ku në timon ishte Markeljan. Sapo kanë hipur në au-

**AKUZA**  
Në masakrën pranë maternitetit të vjetër të ndodhur pasditen e datës 27 maj 2015, mbetën të vrarë Mentor Lufi, Besnik Sulku dhe Gerti Goxhaj. Dy vëllezërit Doçi dhe Letizia akuzohen se kanë kryer veprime aktive në konfliktin e armatosur ku mbetën të vdekur shtetasit Mentor Lufi (Doçi), Gerti Goxhaj dhe Besnik Sulku.

tomjete, në dy pjesët anësore të makinës së parë, janë afruar dy persona të armatosur, të cilët kanë qëlluar personat që gjendeshin në bordin e saj, konkretisht Mentor Lufin (Doçi) dhe Gert Goxhaj. Nga goditjet me armë ka vdekur në vend Goxhaj dhe është plagosur rëndë Lufi, i cili vdiq pak çaste më vonë. Në momentin e goditjes me

armë, Markeljan Doçi afron me shpejtësi makinën drejt atentatorëve, duke përplasur fillimisht njërin prej tyre. Ky i fundit, i cili më pas rezultoi se ishte Besnik Sulku, ka qëlluar me pistoletë në drejtim të mjetit të dytë, por pa u shkaktuar dëme tek vëllezërit Markeljan dhe Klejvi Doçi. Të gjendur nën goditjen e armës tip pistoletë nga ana e

Besnik Sulkut, Markeljan, gjithashtu, i armatosur me pistoletë, ka reaguar duke qëlluar me armë. Markeljan dhe Sulku kanë vijuar të qëllojnë njëri-tjetrin, derisa Besnik Sulku ka mbetur i vdekur, pak metra larg nga automjetet. Menjëherë pas ngjarjes, forcat e policisë organizuan operacionin për arrestimin e personave të përfshirë. Fillimisht, në vendngjarje u arrestuan vëllezërit Markeljan dhe Klejvi Doçi. Më vonë, pranë një hoteli në atë zonë, u arrestua edhe shtetasi italian, Salvatore Letizia, i cili rezultoi se është personi që, së bashku me Besnik Sulkun, ishte pjesë e vrasjes së shtetasve Mentor Lufi dhe Gerti Goxhaj.

**Superoperacion në Ballkan, 180 të arrestuar, mes tyre shqiptarë**

**N**jë aksion me shtrirje të gjerë në Gadishullin e Ballkanit, por edhe në koordinim me strukturat EUROPOL, FRONTEX, INTERPOL ka finalizuar kapjen e 300 kg drogë si dhe 160 armë të tipave të ndryshme. Aksioni ka nisur nga 5-9 shtator, ndërsa qendra e organizimit ishte në Hagë.

OPERACIONI NË BALLKAN	
<b>ARRESTOHEN 148 PERSONA</b>	
13	arrestime për kalim klandestinë
71	arrestime, emigrantë të paligjshëm
36	arrestime për trafik droge
3	arrestime për trafikantë armësh
5	arrestime për trafik droge dhe armësh
16	arrestime për mashtimin me dokumente
4	arrestime, nuk jepet specifikimi

Ky operacion u zhvillua në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, ndërsa persona të infilturuar ishin rreth 8300 agjentë nga 28 vende të ndryshme, madje edhe brenda vendeve të Bashkimit Europian, të cilët bënë të mundur identifikimin e këtij grupi. Ky aksion është ndarë në dy faza, gjatë fazës së parë janë arrestuar 32 persona, ndërsa 148 të tjerë në fazën përfundimtare. Pas veprimit të koordinuar, strukturat e posaçme kanë arrestuar 180 persona, duke përfshirë sekuestrimin e armëve dhe arrestimin e kontrabandistëve të drogës, emigrantët e paligjshëm dhe personat, të cilët dyshohet se kanë dorë në falsifikimin e dokumenteve.

**Itali, kapen me 800 kg kanabis në furgon, arrestohen dy shqiptarë**

**ITALI** - 800 kg kanabis dhe dy shqiptarë të arrestuar është bilanci i një operacioni të zhvilluar nga policia italiane në Foxhia. Mësohet se të arrestuarit janë Marsel Brakollari dhe Xhuljano Haxhiraj përkatësisht 25 dhe 22 vjeç. Lënda narkotike ishte fshur në furgonin ku udhëtonin dy të rinjtë shqiptarë. Policia ra në dyshim e, pasi drejtuesi i mjetit



nuk iu përgjigj thirrjes për të ndaluar, ndaj edhe u vu në ndjekje të tij. Pas ndalimit, gjatë kontrollit të mjetit, u gjetën dhe sekuestruan 800 kg kanabis, e cila nëse do të dilte në treg kapte vlerën e 6 milionë eurove.



## NJOFTIM PUNËSIMI

### POZICIONI I PUNËS: DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO

INSTITUTI EUROPIAN PASHKO është një organizatë jofitimprurëse themeluar nga EEI / Iniciativa Europiane për Edukim, si agregim i më shumë se 10 viteve veprimtari në mbështetje të: lirisë ekonomike, inovacionit, lirisë së shtypit, botimeve dhe de batit të ideve, kreativitetit dhe të trashëgimisë kulturore. IEP udhëhiqet nga vlerat e aksionit afirmativ, europianizimit të shoqërisë shqiptare, reformizimit, liberalizimit ekonomik dhe politik, për nder të ideve të profesor Gramoz Pashko, emrin e të cilit mban ky institut, falë dashamirisë së familjes Pashko. / GRAMOZ PASHKO, profesor, ekonomist liberal, figurë sui generis intelektuale, një nga liderët e lëvizjes demokratike të "Dhjetorit 1990" dhe themeluesi i universitetit të parë privat në Shqipëri në vitin 2002. /IEP do të promovojë nëpërmjet gjashtë programeve vlerat e demokracisë liberale, ekonomisë së lirë të tregut dhe europianizimit.

#### DOKUMENTET E KËRKUARA

CV e hollësishme  
Diplomë Master Shkencor / PhD / Certifikata të ndryshme

#### KRITERET

Të ketë përfunduar studimet në Shkenca Politike/ Juridik / Shkenca komunikimi / Menaxhim / Marketing ose në fusha të përafërta. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe strategjike për negociim me të tjerët. Kandidati duhet të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie me palët e interesuara, partnerët e IEP, institucione jo-qeveritare dhe qeveritare, institucionet rregullatore dhe mediat. Gjithashtu duhet të ketë eksperiencë në zhvillimin strategjik dhe zbatimin e modeleve të anëtarësimit dhe kodet e sjelljes, si dhe të ruaj një vlerësim të lartë të rëndësisë së markës dhe objektivave të organizatës që drejton

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës  
20 Shtator 2018, ora 15.00, në adresën: [kebjana.haka@uet.edu.al](mailto:kebjana.haka@uet.edu.al)



PROGRAMET E INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO



## DO TË JESH PJESË E STAFIT AKADEMIK TË UET? APLIKO TANI!

### I UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS REKRUTON STAF NË FUSHAT:

1. Shkenca Ekonomike
2. Shkenca Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
3. Shkenca Humane, Edukimi dhe Arte Liberale
4. Shkenca të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës
5. Shkenca Mjekësore Teknike

### II DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PEDAGOGUT

1. Mësimdhënie në tre ciklet e studimit BA/MA/DR
2. Këshillim i studentëve
3. Angazhimi në veprimtari kërkimore - shkencore
4. Mbështetje për institucionin

### III KRITERET E NJË KANDIDATI TË SUKSESSHËM

1. Preferohet që kandidati të ketë përfunduar të paktën një cikël studimesh (BA/MA/DR) në një universitet anglo-sakson.
2. Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë dhe t'i përgjigjet me fleksibilitet nevojave të universitetit;
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë dhe në fushën e kërkimit shkencor të mirëfilltë.

### DOKUMENTET E KËRKUARA

- #### IV
- CV e hollësishme e kandidatit në gjuhën shqipe.
  - Letër motivimi në të cilën të shpjegohen qartë interesat profesionale, fushat e ekspertizës dhe lëndët e synuara.
  - Kopje të listës së notave, shoqëruar me diplomën përkatëse të ciklit të parë dhe të dytë. (notë mesatare mbi 9-të).
  - Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/ titujve akademikë
  - Për studimet e kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, diploma duhet të jetë e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

-Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në: [hr@uet.edu.al](mailto:hr@uet.edu.al) ose në zyrën e Burimeve Njerëzore deri më 20 Shtator 2018.

-Konkursi zhvillohet në datat 26-27-28 Shtator 2018

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, [info@uet.edu.al](mailto:info@uet.edu.al)



FAKULTETI I EKONOMISË BIZNESIT DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE JURIDIKE POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDERKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE EDUKIMIT DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË INFORMATIKËS DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Zaev: Dështimi i marrëveshjes, rrezik për kaos dhe izolim të vendit

# Johannes Hahn: Asnjë shtet nuk hyn në BE pa liri të mediave

## Sekretari amerikan: Mbështesim marrëveshjen e Prespës

Vetëm dy javë para referendimit në Maqedoni, këtë të hënë në Shkup mbërritën për vizitë Sekretari Amerikan i Mbrojtjes James N. Mattis dhe Komisioneri evropian për zgjerimin Johannes Hahn. Marrëveshja është kushti thelbësor për integrimin e plotë të Maqedonisë në NATO e BE. Komisioni për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn ndodhet për vizitë në Maqedoni, përpara referendimit të 30 shtatorit për ndryshimin e emrit. Nga Shkupi, ai ka deklaruar se asnjë vend i Ballkanit nuk do të integrohet në Bashkimin Evropian, nëse nuk garanton liri dhe pavarësi të plotë të mediave dhe gazetarëve. Këtë deklaratë e bëri në konferencën "Ditët e medias Bashkim Evropian - Ballkan Perëndimor", raportojnë mediat maqedonase. Sipas tij, janë rritur rastet e dhunës ndaj gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Pa një gjyqësor të pavarur, nuk ekziston liria e medias, u shpreh Eurokomisioneri Hahn nga Shkupi. "Hija" e ndikimit rus në referendumin për emrin në Maqedoni, sollë vizitën zyrtare në Shkup të Sekretarit Amerikan të



Komisioneri evropian për zgjerimin Johannes Hahn

Mbrojtjes, Xhejms Mattis. Shefi i Pentagonit shprehu mbështetjen e plotë për votën popullore të 30 shtatorit dhe përgëzoi Shkupin dhe Athinën për marrëveshjen e Prespës. "Referendumi i ardhshëm është vota më e rëndësishme

në historinë e kombit tuaj. Do të vendosni për të ardhmen tuaj. Vota pro do të sjellë siguri të përfortuar dhe më shumë zhvillim ekonomik. Ne jemi të gatshëm t'ju mirëpresim si anëtarja e 30-të e NATO-s", tha James Mattis, Sekretar

Amerikan i Mbrojtjes. Gjatë një deklaratë me herët me gazetaret, Mattis shprehu shqetësimin për përfshirjen e Rusisë në fushata kundër referendimit. Në të njëjtën linjë me Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes është edhe Shefi

### JAMES MATIS:

"Referendumi i ardhshëm është vota më e rëndësishme në historinë e kombit tuaj. Do të vendosni për të ardhmen tuaj. Vota pro do të sjellë siguri të përfortuar dhe më shumë zhvillim ekonomik. Ne jemi të gatshëm t'ju mirëpresim si anëtarja e 30-të e NATO-s", tha James Mattis.

gishtin nga Rusia, duke akuzuar për fushata masive online, kundër referendimit. Ndërkaq kryeministri maqedonas Zoran Zaev paralajmëron votuesit se dështimi i marrëveshjes me Greqinë rrezikon ta zhysë vendin në kaos dhe izolim ndërkombëtar. Komentet i bëri për agjencinë e lajmeve AFP, përpara takimit elektoral në mbështetje të marrëveshjes në Kërçovë. Jo vetëm shumica qeverisëse dhe partitë shqiptare, por edhe zyrtarët të lartë të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian janë angazhuar intensivisht për të nxitur votuesit maqedonas të mbështesin marrëveshjen për emrin e ri "Maqedonia Veriore" në referendumin e 30 shtatorit.

## Prindër! Arritjet e mëdha në jetë

shijohen kur siguroni shëndetin e fëmijës suaj!

SiCRED garanton mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast të çdo të papriture shëndetësore apo aksidentale. Kontrata ofron një gamë të gjerë mbulimesh dhe përfitimesh, duke marrë parasysh dhe aktivitetin e përditshëm të nxënësve si dhe 60% zbritje në spitalet dhe klinikat private në Shqipëri.



Sigurim për Jetën



Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike

**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

**SIGURIMI  
JETA e NXËNËSVE**

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al

## SHFAQJA



Skena nga shfaqja



# ARTUR SCHNITZLER

## Hipokrizia e jetëve intime, burra këmbëzbathur e gra me taka

Fatmira Nikolli

Kur drama "Reigen" (Rrethi) e Arthur Schnitzler u vu në skenë vjeneze më 1921, teatri u mbyll nga policia dhe pas një gjyqi 6-ditor, vetë autori vendosi që pjesa të mos shfaqej më. Sfondi ishte një epidemi sifilizi. Mund të mendohet 'skandal' në sytë e grave të veshura me fustane 'corsette' me 'balena' dhe burrave me kapele eduardiane, që shihnin në skenë atë që nuk ia pranonin vetes, shoqërinë e palumtur dhe me gjasë tradhtitë që i fshihnin njëri-tjetrit. Drama e Schnitzler ka 10 skena, ku vendosen përballë njëri-tjetrit prostituta dhe ushtari, ushtari dhe shërbëtorja, shërbëtorja dhe zotëria i ri, zotëria i ri dhe gruaja e re, gruaja e re dhe bashkëshorti saj, bashkëshorti dhe vajza e ëmbël, vajza e ëmbël dhe poeti, poeti dhe aktorja, aktorja dhe konti, konti dhe prostituta e skenës së parë.

Përveç prostitutës që është vetvetja - gruaja që shkon me të gjithë pa premtuar e pa marrë premtime besnikërie, të gjithë të tjerët fshehin dhe fshihen, teksa premtojnë dy herë brenda natës dashuri të përrjetshme.

100 vite më pas, pa veshjen vintage - të dhjeta skenat vijjnë në teatrin 'Migjeni' nën regjinë e Alois Gallé, si bashkëpunim i Ambasadës së Austrisë, teatrit 'Migjeni' dhe Bashkisë së Shkodrës.

Janë sërish dhjetë skena e dhjetë aktorë ku asnjëri nuk është besnik ndaj tjetrit; ata flenë së bashku, por nuk ndiejnë dashuri. Ata ndihen të vetmuar edhe kur nuk janë vetëm. Vetmia nuk është fati i tyre, por faji i tyre. Jeta e bazuar në gënjeshtra dhe mashtrim, në lakmi dhe në superficial-

itet, sjell si mendim vdekjen duke nxitur tundimin për të shijuar momentin. "Reigen" tregon me anë të dhjetë dialogëve erotike shoqërinë vjeneze të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX dhe moralin e saj hipokrit seksual. Të gjitha shtresat sociale, që nga proletariati e deri tek aristokracia, enden në një rreth. Regjisori austriak Alois Gallé vë përballë gratë me taka e fustane e burrat këmbëzbathur me kostume, sepse ndryshe nga Artur Schnitzler, gratë nuk duhet të jenë viktima. Skenat erotike janë po 10, sa dialogët, duke risjellë me 'sikur-in' e teatrit, aktin seksual mes çifteve publike dhe çifteve që thejnë kurorën. Pjesa është përkthyer nga Jonila Godole dhe në role kanë janë Krist Lleshi, Sara Smaja, Julinda Emiri, Ina Gjonci, Loredana Gjeçi, Nikolin Ferket, Simon Shkreli, Pjerin Vlasi, Jozef Shiroka dhe Frederik Fistani. Në intervistën e tij për "Gazeta Shqiptare", ai flet për konceptin e tij mbi pjesën që u vu në "Migjeni" në datat 14, 15, 16 shtator.

**-Si ndiheni pas premierës?**  
Si pas çdo premiere tjetër unë nuk mund të them. Duhen pyetur aktorët. Nuk kemi më gjë tjetër për të bërë, kemi mbaruar. Është si një boshllëk brenda meje.

**-Është ajo që i ndodh çdo artistit kur e kryen veprën?**  
Nuk e di nëse çdo artisti, por çdo njeri të teatrit i ndodh kështu. Një piktor për shembull ka mundësinë që ta ripikturojë veprën edhe pasi



Regjisori, Alois Gallé

*Alois Gallé: Nuk doja që gratë të ishin viktima si te "Rrethi"*

e ka përfunduar. Mundet ta ribëjë ose ta rishohë edhe pas 10 vitesh po të dojë, për të ndryshuar në të. Këtë mundësi nuk e kanë njerëzit e teatrit. Të krijohet ndonjëherë përshtypja se mund të kishë shumë gjëra për të provuar, për të bërë më shumë prova, por pasi e ke vënë në skenë, nuk e ke më këtë mundësi.

**-A keni mundur të shihni në skenë atë që keni pasur në mendje kur keni lexuar veprën dhe keni vendosur të bëni regjinë e saj?**

Po. Kjo është detyra ime. Nëse nuk bëhet kjo, atëherë ka një problem.

**autor i lehtë as për Austrinë as për Shqipërinë. Në Austri e ka shkaktuar 'skandalin' 100 vite më parë. Si me "Ëndrrën" edhe me "Rrethin", ai përqendrohet te raportit i njeriut me erotizmin po pa mundur të jetë i lumtur.**

Kjo ndodh edhe në këtë pjesë. Është kërkesa për dashuri. Për dashuri që nuk plotësohet. Është një problem që ishte edhe atëherë, problem që është aktual edhe tani.

**-Burrat ishin këmbëzbathur dhe me kostum në skenë, ndërsa gratë me taka dhe me fustane. A keni dashur të tregoni epërsinë e burrave me kostum apo epërsinë e grave me taka?**

Tek Schnitzler të gjitha gratë mbarojnë keq, kanë një fund të keq, janë viktima. Do të ishte ndryshe nëse burrat do të trajtoheshin si 'maço' që i keqtrajtonin gratë e ndryshe si u trajtuan këtu, që gratë janë me taka dhe në një farë mënyrë i vënë përfund burrat.

**-Pra, nuk vihet në zbatim perceptimi i burrave që përdorin pushtetin e i grave që përdorin trupin?**

Nuk doja të thosha që burrat kanë pushtetin dhe gratë trupin. Doja përkundrazi që në skenë (në konceptin regjisorial) gratë janë mbrojtur, çka nuk tregohet te Schnitzler. Në shfaqje në disa skena, si te pjesa e guajtjes me jastëk apo tek çifti me poetin, gratë janë mbrojtur, nuk janë më në rolin e viktimitës, ato tani kanë nxjerrë kthetarr, po luftojnë. Në fakt, do të doja të dija re-

agimin e burrave shqiptarë, si e kanë parë ata këtë fakt. Kjo logjikë është ndjekur deri në fund të pjesës. Aktoret (femra) dalin në skenë dhe duartrokiten ndërsa aktorët (burra) rrinë pas derisa shkojnë vajzat dhe i marrin për t'i afruar te publiku.

**-Ka qenë një mesazh i juaj ky për meshkujt shqiptarë?**

Nuk do të thosha që doja t'u jepja një mesazh meshkujve shqiptarë, por doja që gratë të mos ishin vetëm viktima. Doja që në skenat erotike, të luante një rol fantazia dhe të kuptohej më shumë prej asaj që shikohej. Kam dashur t'i lë publikut të mendojë më tepër se sa thonë veprimet në skenë. Në variantin tim, femra nuk duhet të jetë viktima, por është publiku ai që e kupton si do pjesën. Me elementë të vegjël kam dashur të lë publikun të mendojë si është a si duhet të jetë, pa thënë unë se si është a si duhet të jetë.

**-Në veprën e Schnitzler, skenat e veprimit janë me çifte, dy e nga dy, një burrë dhe një grua. Kur biseda bëhet janë vetëm ata. Ndërsa ju, krijoni rreth: të gjithë personazhet janë aty dëshmitarë, ndërsa çiftet e radhës luajnë pjesën që u takon. A keni dashur të vini hipokrizinë përballë të vërtetës?**

Ishte e qëllimshme. Është si një skenë kur një i sëmurë, është në shtrat, të gjithë i vijnë rrotull por nuk bëjnë asgjë - veçse acarohen e indinjohen. Vetëm kur vjen urgjenca zgjidhet kjo situatë.

DOBITË SHËNDETËSORE TË FARAVE TË SUSAMIT.

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E martë 18 Shtator 2018



**Enca, sërish me poza provokuese nga pushimet**



**"Dita e parë mbaroi..."**, çfarë ka dashur të thotë Trejsi Sejdiçi?

**BULEVARDI POLITIK**



- Përurimi i shkollës "Kosova", Rama "nuk ta del dot" me nxënësin në basketboll
- Këndoi me Tërmet Peçin, rrëfimi i Golikut: Si e rrëzova Enverin nga karrigia
- Veshja e vajzave të Metës ra në sytë e të gjithëve, zbulohet 'dora' që fshihet pas tyre
- Deputeti i PS, urim të vëllait për ditëlindje: Je pasqyra ku shihem



Refehët ventrilokuistja: Dëshira ime për të qenë në art dhe vëmendja ndaj biznesit

## ARJETA DHIMA:

**Ju tregoj të fshehtat e ventrilokuizmit, ja si i jap shpirt artit**

*"Familja është përkufizimi i lumturisë"*

Grëfhet ventrilokuistja: Dëshira ime për të qenë në art dhe vëmendja ndaj biznesit

# Arjeta Dhima: Ju tregoj të fshehtat e ventrilokuizmit, ja si i jap shpirt artit

*"Familja është përkufizimi i lumturisë"*

Egla Xhemali

Ajo është ventrilokuistja e parë në Shqipëri. Në fakt, në të gjithë globin janë gjithsej pesëdhjetë ventrilokë që kanë aftësinë të ushtrojnë këtë art, që është po aq i lashtë sa dhe Greqia Antike. Për të ndarë me ne të fshehtat e magjisë së interpretimit vjen për "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare" Arjeta Dhima. Artistja që e do fort punën e saj është jo vetëm profesioniste në atë që bën, por dhe mjaft e zonja të kryejë njëherazi një sërë aktivitësh. Kur flitet për ventrilokuizmin shumica e njerëzve thonë me bindje se aftësia për ta praktikuar atë është e lindur. Në fakt, Arjeta është shembulli që tregon se gjithçka arrihet me vullnet. Për ata që nuk e dinë çfarë është arti që Dhima zotëron më së miri po shpjegojmë termin. "Ventrilokuizmi" do të thotë të flasësh me bark, pa lëvizur aspak buzët, dhe fjalët të jenë të qarta si një e folur normale. Raporti që ka me kukullën Sindi është përtej atij artistik. Ajo e ka përjetësuar duke i dhënë shpirt asaj. Vendi ku ndihet çdoherë e qetë është familja. Ata kuptojnë dhe mbështesin gjithçka që ajo ndërmer. E ëma mbetet kryefjala që i lexon të gjitha mendimet. Më tej, artistja na tregon se ndihet shumë mirë pasi ka humbur disa kila me një dietë të shëndetshme, ku me të qeshur pohon se kjo është mënyra më e mirë për të jetuar. Nuk na humbet dhe një copëz e vogël e jetës personale megjithëse asaj nuk i pëlqen ta ekspozojë atë. Arjeta rrëfen për ne eksperiencën që deri më tani ka rezultuar e suksesshme. Është viti i katërt, që ventrilokuistja është drejtuese e një studioje aktrimit dhe të folurit në publik. Ajo e sheh artin dhe biznesin si një binom të pandarë që shpreson që gjithmonë t'i bëjë paralelisht pasi pasioni për to është i madh. Së shpejti, Arjeta do të vijë me projekte dhe surpriza të reja për publikun. Deri atëherë na ulet të presim.

**Si ventrilokuiste, cili është personazhi që shpreh më shumë mendimet e tua?**

Deri tani kemi vetëm tri person-



azhe që po shohin dritën e skenës. Është Xha Teli, goca dhe Sindi. Mund të them për këtë të fundit se është një nga kukullat që mund të shprehem më lirshëm. Ajo i njeh mendimet e mia, sepse është kukulla që më ka shoqëruar për katër vjet dhe kemi mësuar bashkë ventrilokuizmin. Është kukulla që m'i njeh lotët, më njeh gëzimin, ndjenjat. Ndërkohë, unë ia kam transmetuar asaj dhe kemi një bashkëpunim shumë të mirë me njëra-tjetrën. Sa i përket të shprehurit tim me anë të një kukulle, unë në detyrën time ventrilokuiste me secilin nga ato dhe jap maksimumin dhe do të ishte profesionale nëse do të thosha të njëra kukull jepem 100% dhe tek tjetra jepem 80%. Kjo nuk ndodh, sepse gjithmonë artisti duhet të jetë ai që investon maksimalisht si të rolet, pjesët që bën, ashtu dhe të personazhet sidomos të këto që janë të veçantë dhe kërkojnë një vëmendje ndryshe.

**Çfarë përgatitjeje fizike kërkon ventrilokuizmi?**

Përgatitjen fizike nuk është se e kërkon vetëm ventrilokuizmi, ky i fundit e kërkon më të specifikuar, por e kërkojnë që nga sportet që tek aktorët e thjeshtë, për të vijuar me artistët e operës dhe të baletit. Kjo lloj përgatitjeje normalisht që duhet të jetë të çdo individ, të biznes-

menët edhe të mësuesit domethënë tek të gjithë ata që kanë aktivitet gjatë ditës dhe duhet të jenë në një performancë. Nuk është e thënë që të jenë në skenë e duhet patjetër të bësh aktivitet fizik, por unë në këto momente jua rekomandoj të gjithëve sidomos ecjen e shpejtë. Në ventrilokuizëm ndryshon pak puna, sepse duhet të merresh që nga muskujt facial, diafragma, muskujt e duarve. Janë shumë gjëra specifike të vogla, që ndihmojnë në një performancë absolute. Përgatitja fizike duhet të jetë e përditshme. Ajo kërkon një diafragmë shumë të përgatitur e disa muskuj diafragme të stërvitur mirë.

**Kur thua se një rol të ri e ke plotësisht të përvetësuar?**

Përballem me rolet e reja unë e kam të thuash si dashuri me shikim të parë. Përpiqem që ta kuptoj në leximin e parë për çfarë bëhet fjalë dhe pastaj e plotësoj. Një rol ndoshta nuk arrihet asnjëherë në atë maksimumin e vet, por unë mendoj se ka arritur momenti i 100%, kur i vendos titullin e fundit atij roli. Më gëzojnë rolet e filmat shumë, po ashtu dhe ato të teatrit. Filmi është bërë komod për mua duke qenë se kam qenë goxha aktive gjatë këtyre vitit me filmat e metrazhit të shkurtër dhe me risitë e reja që janë sjellë në teknologjinë e xhirimit të tyre. Nuk e di tamam kur mund të



them që është i realizuar. Sa i përket xhirimeve të një filmi them që dubli i fundit ka vendosur gjithçka kurse në teatër, po shfaqja e fundit e ka vendosur vullën që ky ka qenë një rol i realizuar. Në fakt, nuk mund të flasim dot në për rolet e realizuara apo jo, sepse kemi një audiencë, kemi një publik që bën atë gjykesin në njëfarë mënyre.

**Si ndihesh tani me disa kg më pak?**

Sa i përket kilogramëve të mi nuk kam bërë ndonjë publikim që jam kaç kilogramë më pak apo jam aq. (qesh) Unë po bëj një rënie natyrale në peshë, sepse duhet për shkak të të qenit mirë me shëndet. Ndihem mirë nuk është se po e përjetoj çuditshëm, por është një proces që zgjat bukur me një frigorifer të mbushur me gjëra jeshile dhe me një dollap bosh. Është i këndshmi proces. Mbi tavolinë gjenden vetëm një shishe ujë. Besoj që të gjithë duhet ta kuptojnë që kështu duhet të jetojmë. (qesh)

**Kush është personi që arrin të'i lexojë mendimet?**

Kur hyj tek pjesa personale e gjërave e kam pak të vështirë të përgjigjem pasi ka disa vite që më ka rrimber pjesa e punës. Normalisht më është dashur të përgjigjem vetëm për të mbarevajtjen e saj, si dhe për anën profesionale e artistike. Personi që di të më lexoj mirë dhe më kupton unë besoj që gjithmonë për fëmijën e vet është nëna. Mami im është një nga personat që arrin të më kuptojë dhe të më jap mbështetjen e saj. Nuk dua të përjashtoj faktin që ka dhe miq dhe mikeshë që mua më gjenden pranë në momente delikate të miat. S'e di në mund të përmend emra pasi ka disa persona që të përgjigjen dhe të

kuptojnë në aspekte specifike. Për shembull, disa më kuptojnë në marrëdhëniet me punën, disa të tjerë në marrëdhëniet shoqërore e këshu me radhë, por kryefjala mbetet mami.

**Me kë jeton?**

Unë për momentin jetoj vetëm. Kam një apartament të këndshëm. Jetoj në një privatësi të mirë që më ndihmon t'i organizoj gjërat më mirë. Dhe të kem një lloj "pavarësie", për të pasur një komoditet dhe për t'iu përshtatur orareve të punës dhe provave.

**Çfarë pret të ndryshosh në jetën personale?**

Është hera e parë që më drejtohen me pyetje personale dhe është intervistë realisht jo shumë komode për mua, por mund të them që jam duke ndryshuar pak stilin e jetesës, po organizoj orët e gjumit pasi i kam pasur të pakta dhe normalisht që ndikonin në pjesën e produktivitetit në punë. Dua të ndryshoj patjetër pjesën e financave, pastaj për pjesë të tjera lidhje, fejesë apo martesë preferoj të mos përgjigjem pasi ju t'i përdorni. (qesh)

**Vendi që të qetëson shpirtërisht?**

Vendi që më qetëson shpirtërisht pavarësisht se ku ndodhemi është pranë familjes sime ku unë vendos kokën të prindërit, kur ndjej përqafimin e vëllezërve të mi ose kur u dëgjoj zërin jam realisht e qetë. Pastaj për vende specifike që mund të jenë turistike nuk është se kam një vend të preferuar. Janë disa vende në Shqipëri që më pëlqejnë dhe mbushem me ajër, por gjithmonë është familja ajo që më qetëson.

**Çfarë i thua vetes kur diçka**



## Enca, sërish me poza provokuese nga pushimet

Enca Haxhia vazhdon të jetë një ndër personazhet më të komentuar në rrjetet sociale. Imazhet provokuese që nxjerr, bëjnë që ajo të jetë çdo herë e më shumë e përfolur në media. Pas një sezoni të mbushur me koncerte dhe pas punës për projektet e reja, Enca ka vendosur që më në fund t'i japë vetes disa ditë pushimi. Në rrjetin "Instagram", ajo ka publikuar disa fotografi mjaft provokuese me bikini, duke i lënë pa fjalë fansat e saj. Kështu, bukuroshja ka vënë në plan të parë të pasmet, duke pozuar nga prapa. "Mona Enca" ka qenë mbishkrimi që ajo i ka lënë fotografisë, ndërsa ka marrë mijëra pëlqime e komente nga ndjekësit e saj të shumtë.



## "Dita e parë mbaroi...", çfarë ka dashur të thotë Trejsi Sejdiu?

Është vetëm 18-vjeçare dhe duket se fama e merituar si "Gangsterja e Elbasanit" i ka dhënë gjithashtu edhe luksin e të konsideruarit si një nga femrat më 'hot' të "show bizz"-it. Ndoshta, të gjithë i admironi format e saj tepër të zhvilluara dhe sensuale, ndërsa nga ana tjetër Trejsi ka treguar anën e saj "të ëmbël". Bukuroshja me postimet në "Instastory" ka treguar teksa ka mbaruar edhe ditën e parë të shkollës, ku në fokus janë disa libra dhe një buqetë me lule. Suksese Trejsi! Le të shpresojmë që ky vit të sjellë vetëm rezultate të mira në mësim.



bërë diçka të bukur dhe ndryshe, që të sjelli pjesën tjetër pastaj, që quhet biznes. Shpresoj që të mos e humb asnjëherë dëshirën për të qenë në art dhe vëmendjen për të qenë në biznes.

### Një projekt që ke në dorë?

Me Arjetën nuk flitet asnjëherë vetëm për një projekt. Vetëm për këtë periudhë unë jam duke përgatitur një rol që duhet të zhvilloj brenda këtij muaji me regjisorin Jonid Jorgji. Kam projektet me studio time pasi kam një studio aktrimit dhe më duhet që pothuajse çdo tre muaj të jem përballë një skene me aktorët që përgatiten aty. Me projektet e të folurit në publik jam gjithmonë në punë. Projektet e ventrilokuizmit, meqenëse ju e nisët me të gjithë këtë intervistë, kemi të reja. Jemi në punë duke përgatitur diçka shumë interesante. Është akoma herët për të folur sepse jemi në proces pune artistike që në momentin që do i vendosim pikat mbi 'i' besoj do të na floni për një intervistë tjetër. (qesh)

### Çfarë të reje sjell në avangardë stili yt i spektaklit?

Tek pjesa e ventrilokuizmit është diçka e re dhe ndryshe, që është sjellë kohët e fundit në Shqipëri dhe realisht është përparësi. Sa i përket vëmendjes që mund të ketë audiencia, njerëzit tregojnë të shohin dhe të dëgjojnë çfarë të reja po sillen dhe si po sillen ato. Në stilin e spektaklit nuk mund të shquaj apo të përmend diçka ndryshe, por unë fus këtu edhe pjesën e interpretimit. Përpigëq gjithmonë të jem te pjesa e karakterit e të jem konkrete. Kjo është ajo që e bën aktorin të vërtetë dhe bindës në skenë. Ventrilokuizmi është gjithmonë ndryshe, është avangardë, që realisht publiku të ketë një qasje shumë të mirë dhe interesante.

### nuk shkon siç duhet?


Dal përpara pasqyrës dhe flas shumë hapur me veten. "Dëgjo moj vajzë! Arjeta a ka mundësi të bësh një ristart të vetes dhe të marrësh forca të reja pasi kjo gjëja kërkon shumë impenjim, përkushtim dhe adrenalinë nga ana jote dhe ti duhet të jesh me forca të reja për ta përballuar. Hajde vajzë e mbarë, çohu bëje!" Nuk ka gjë më të mirë se sa t'i thuash vetes çohu dhe mos të presësh të ta thotë të tjerët këtë fjalë, sepse është më e rëndë kur ta thotë dikush tjetër. Kur ia thua vetes patjetër që është e rëndë, por ama e ke përballjen me veten dhe e gjen ti forcën që ke brenda për të reaguar.

### Arjeta në biznes apo në art?


Arjeta ka rreth katër vjet që gjendet përballë një drejtimi të ri të një studioje aktrimit dhe të folurit në publik. Nuk është e thjeshtë për mua, sepse unë di të bëj vetëm një pjesë që është ajo e skenës dhe pjesë menaxheriale e bëjnë të tjerët, por vendimet duhet t'i marr unë. Gjendim mirë tani pasi ka kaluar kohë dhe kam marrë veten disi, por nuk mundem absolutisht në asnjë sekondë të shmang Arjetën artiste. Arjeta artiste është e para që i bën këto dhe i vë në lëvizje, që të funksionojnë dhe pastaj vjen ana e biznesit që normalisht duhet të jetë pasioni dhe forca e brendshme për të

## Tuna ka disa fjalë për të thënë për Mozzikun dhe Loredanën

Tuna ka fjalë të mira për çiftin e famshëm. Mozzik dhe Loredana kanë sjellë bashkëpunimin e tyre të parë, këngën me titullin "Bonnie & Clyde". Këngëtarja Tuna Sejdiu po e vlerëson shumë që dyshja po punon edhe në projekte bashkë, e madje ka shkruar një status ku ka publikuar edhe foton e tyre. Tuna ka shkruar: "I admiroj çiftet që punojnë bashkë, ky është vetë



arti... shumë lezetshëm". Kjo nuk është hera e parë që çifti vijnë bashkë në një projekt, megjithatë, Mozzik ishte bashkëpunëtori më i afërt i këngës debutuese të Loredanës, madje



## KESHILLA

Një nga farat e para që njerëzit i kanë përdorur për prodhimin e vajit janë farat e susamit. Përveç se në kuzhinë, qysh nga lashtësia përdoren edhe për mjekësinë tradicionale si preventivë dhe për shërim të sëmundjeve.

**F**arat e susamit janë për plot me fitonutrientë si acidet yndyrore omega-6, flavonoid fenolet, d.m.th. antioksidante, vitamina dhe fibra ushqyese me veçori potencialisht antikancerogjene.

**1.** Në 100 gramë susam gjenden 573 kalori. Edhe pse shumica e kalorive vijnë nga yndyrat e çmueshme, susami përmban edhe minerale të rëndësishme, antioksidantë dhe vitamina, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin.

**2.** Farat janë veçanërisht të pasura me acidet yndyrore mono-të-pangopura (acidi oleinik), të cilat përbëjnë deri 50 për qind të acideve në susam. Acidi oleinik ndihmon të ulët LDL ose kolesterolin i keq dhe rritet HDL ose kolesterolin i mirë në gjak. Hulumtimet shkencore tregojnë që ushqimi mesdhetar i cili është i pasur me acidet mono-të-pangopura ndihmon që të parandalohet sëmundja e artereve koronare dhe sulmi në zemër.

**3.** Farat e susamit po ashtu janë burim shumë i vlefshëm i proteinave ushqyese, d.m.th. i aminoacideve kualitative që janë të domosdoshme për rritjen, veçanërisht të fëmijët. Vetëm 100 g fara sigurojnë rreth 18 g proteina (32 për qind e vlerave të rekomanduara ditore).

**4.** Përveç kësaj, farat e susamit përmbajnë kompozime siç janë sesamoli (3, 4-metilen-dioxyphenol), sesaminol, furil-methanthiol, guajacol (2-methoxyphenol), phenylethanthiol, furaneol, vinylguajacol dhe decadienal. Sesamoli dhe sesaminoli janë antioksidantë fenole. Së bashku këto kompozime përbëjnë frontin e fuqishëm kundër radikaleve të lira të dëmshme brenda trupit njerëzor.

**5.** Susami është i pasur me vitamina dhe minerale kualitative. Para së gjithash është burim i mirë i kompleksit B të vitaminave, siç janë niacina, acidi folik, tiamina (vitamina B1), piridoksina (vitamina B6) dhe riboflavina.

**6.** Vetëm 100 g susam përmban 97pr qind të acidi folik, rreth 25 për qind të konsumit të rekomanduar ditor. Acidi folik është i domosdoshëm për



# Dobitë shëndetësore të farave të susamit.



sintezën e ADN-së, ndërsa kjo është në veçanti e rëndësishme për femrat shtatzënë sepse mund të parandalohet dëmtimi i sistemit nervor tek foshnjët.

**7.** Niacina është edhe një vitaminë nga grupi i kompleksit B, e cila gjendet me shumicë në susam. Rreth 4,5 mg ose 28

për qind të nevojës ditore të nivelit të niacinës do t'i gjeni në vetëm 100 g fara. Niacina ndihmon në reduktimin e kolesterolit LDL në gjak. Përveç kësaj, rrit aktivitetin e neurotransmetuesit kryesor (GABA) në tru, çka mund të ndihmojë në reduktimin e ankthit dhe neurozave.

**8.** Farat e susamit janë burim jashtëzakonisht i pasur i shumë mineraleve esenciale. Kalciumi, hekuri, mangan, zinku, magnezi, seleni dhe bakri janë në veçanti të koncentruara në farat e susamit. Shumë nga këto minerale kanë rol kyç në mineralizimin e eshtrave, ndërtimin e qelizave të

kuqe të gjakut, sintezën e enzimeve, hormoneve, si dhe rregullimin e aktivitetit të muskujve të zemrës dhe të skeletit.

**9.** Një grusht me susam ofron nivelet e rekomanduara të antioksidantëve fenolike, mineraleve, vitaminave dhe proteinave.

## Përrurimi i shkollës "Kosova", Rama "nuk ia del dot" me nxënësin në basketboll

Në ditën e parë të vitit të ri shkollor në kryeqytet u inauguroi shkolla e rikonstruktuar "Kosova". Në ceremoninë e përrurimit morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministrja e Arsimit Lindita Nikolla dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. Duke u nisur nga pasioni i tij për sportin, sigurisht që kryeministri nuk mund të largohej pa parë ambientet e palestrës. Kryeministri i pyeti nxënësit që po zhvillonin orën e fizikut se kush ishte më i miri. Ndërsa prej tyre doli vetëm njëri vullnetar për të bërë garë me Ramën në basketboll. Në këtë pjesë duket se kryeministri nuk ia doli dot me nxënësin. Ky i fundit bëri kosh me goditjen e parë, ndërsa Rama nuk ia arriti me të parën dhe iu desh ta provojë për të dytën herë. Ky moment u shoqërua me të qeshura dhe duartrokitje të të pranishmit.



## Këndoi me Tërmet Peçin, rrëfimi i Golikut: Si e rrëzova Enverin nga karrigia

Kur përmendet Bënça, mendja të shkon te burgu ku vuajti disa

vite Fatos Nano. Por, të apasionuarit pas këngës labe e dinë që fshati në fjalë është vendlindja e grupit të famshëm me të njëjtin emër. Dhe ky grup nuk mund të kuptohet pa Golik Ali Jaupin dhe Paron, duetin që udhëheq këngën labe. Goliku u rikthye në "skenë" pak ditë më parë, por vëmendjen e mori kryebashkiaku i Tepelenës. Kjo, për shkak të një kënge kushtuar Enver Hoxhës gjatë festës së çlirimit të qytetit, ku dukej kryetari Tërmet Peçi teksa mbante iso së bashku me dhjetëra të tjerë. Por vetë Goliku i ka kënduar Hoxhës dhe udhëheqësve të tjerë ndër vite. Madje, në një rrëfim të dy viteve më parë, ai tregon edhe një episod të panjohur, shkruan "JavaNews.al". Duke veçuar momentin më të paharruar gjatë viteve në skenë, ai tregon: "Skena vetiu të ofron vërtet momente të veçanta dhe të paharrueshme, por koncertet më absolute dhe emocionet më të veçanta kanë qenë ato përballë Enver Hoxhës. Veçoj këtu interpretimin e këngës 'Rrofsh sa moshë e kësaj toke', këngë e cila e preku aq shumë Enverin, sa e rrëzoi atë nga karrigia ku rrinte i ulur..."



# BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊


## Veshja e vajzave të Metës ra në sytë e të gjithëve, zbulohet 'dora' që fshihet pas tyre

Bora dhe Era ishin shoqëruet e babait të tyre, Presidentit Ilir Meta në takimin me Papa Françeskun në Selinë e Shenjtë. Veshja e tyre e zezë ra në sy, sidomos 'shamia' gjithë detaje në koken e vajzës së madhe, Borës. "Newsbomb.al" mëson se dy vajzat janë veshur nga stilisti i famshëm Joni Peçi. Ka qenë zgjedhja dhe këmbëngulja e tyre që të vishen nga një stilist shqiptar, por shumë i talentuar si Joni. Stilisti ka respektuar deri në detaje Protokollin e Vatikanit për takime të kësaj natyre. Era dhe Bora duken shumë rehat me këto veshje, teksa buzëqeshin para aparatit, të lumtura për takimin me Atin e Shenjtë.



## Deputeti i PS, urim të vëllait për ditëlindje: Je pasqyra ku shihem

Një ditë e veçantë ishte e djeshmja në familjen e deputetit socialist, Pjerin Ndreu. Vëllai i deputetit, Albert Ndreu, feston 40-vjetorin e lindjes. Në këtë moment të veçantë për të, Ndreu i ka bërë një dedikim në rrjetet sociale. "Ti je pasqyra ku ne shihemi e korrigojmë veten. Bashkë me familjen tënde të mrekullueshme, ne jemi krenarë për atë që përfaqëson. Në këtë 40-vjetor të uroj gjithë të mirat e botës", shprehet ndër të tjera Ndreu.



Edhe 100 vella Albert Ndreu! Mbarësi, sukses e ca të do zemra ne jete. Diten kur ti lindi une e mbaj mend. Ka qenë dite gezimi si sot që u bërë 40. Ti u rrite në duart tona. Ke qenë një femije i bukur. Gjithë lagjia bente gare kush të merrte në krah. Si sot 40 vjet une se imagjinoja se se ti do ishe me i miri nder ne. Sot skam dyshim. Je një njeri i rralle që gjithkush do ta dëshironte që të kishte vella si une e Paulini. Ne e kemi kete privilegj. Ti je pasqyra ku ne shihemi e korrigojmë veten. Bashkë me familjen tendë të mrekullueshme ne jemi krenar për atë që përfaqëson. Ne kete 40 vjetor të uroj gjithë të mirat e botës. Te falenderoj për gjithshka ke bërë që ta lartësosh familjen tone duke mos mbarte qofte një gjë negative, megjithëse adoleshenca jote kaloi në vitet e veshtrira të tranzicionit. Singërisht ti je me i miri dhe me të mire se ti nuk ka!



Opinion i Ditës

# Presidenca austriake e Bashkimit European 2018: Siguria dhe Ballkani në fokus

Nga Dr. Johann Sattler

(Vijon nga faqja 1)

... austriak Metternich në shekullin e XIX. Që prej asaj kohe, kjo deklaratë është cituar shpesh për të ilustruar lidhjet gjeografike, historike, ekonomike dhe kulturore të Austrisë me rajonin e Ballkanit, si dhe për të treguar rolin ndërmjetësues që Austria ka luajtur përgjatë historisë, si një urë lidhëse midis Ballkanit dhe Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Përkrahja për formimin e shtetit shqiptar është një shembull i mirë i rolit ndërmjetësues të Austrisë midis vendeve të Ballkanit dhe Fuqive të Mëdha. Këtë rol, Austria synon ta luajë edhe gjatë Presidencës së saj të Këshillit të BE-së. Austria e ka marrë Presidencën e Këshillit të BE-së në një periudhë, kur Evropa po përballëte me sfida të mëdha dhe ndryshime politike. Austria, në këtë gjysmëviti të presidencës së saj do të bëjë më të mirën e vet për të qenë një urë lidhëse midis vendeve të BE-së dhe përtej, në mënyrë që të zgjidhen tensionet brenda saj dhe të mundësohet një Evropë akoma më të fortë.

I. Prioritetet e Presidencës austriake të Këshillit të BE-së

Me marrjen e Presidencës austriake të BE-së (1 korrik-31 dhjetor), nën moton "Një Evropë që mbrohet", Austria është vendosur edhe njëherë përpara mundësisë dhe sfidës për të luajtur rolin ndërmjetësues midis kontrasteve që e karakterizojnë Bashkimin Evropian: kriza ekonomike dhe e refugjatëve, nevoja për ristrukturim dhe forcim të brendshëm të BE-së, implementimi i axhendave kombëtare dhe ruajtjes së unitetit, negociimi i Brexit, por edhe zgjerimi i BE-së me vendet kandidatë. Presidencës austriake i duhet të veprojë dhe ndërveprojë brenda një Evrope me dinamika të ndryshme dhe në këtë ndërveprim forcash, fokusi i Presidencës qëndron në tri prioritetet kyçe:

1. **Siguria:** Presidenca austriake synon forcimin e kufijve të jashtëm të Bashkimit Evropian, duke luftuar emigracionin e paligjshëm, duke forcuar "Frontex-in" dhe duke punuar për një Sistem të Përbashkët Evropian të Azilit.

2. **Prospertiteti:** Sigurimi i prosperitetit dhe konkurrencës nëpërmjet digjitalizimit është një tjetër prioritet i Presidencës austriake. Për të ruajtur konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë evropiane edhe në të ardhmen, Evropa ka nevojë për një politikë inteligjente të transformimit digjital.

3. **Stabiliteti:** Stabiliteti merr formë dhe strukturë kur nuk ekziston rreziqe dhe kërcënime në zonën gjeografike të Evropës. Prandaj, një prioritet shumë i rëndësishëm për Austrinë do të jetë perspektiva e besueshme e BE-së



për Ballkanin Perëndimor. Procesi i integritimit me fuqinë transformuese unike do të mbetet forca lëvizëse për nxitjen e reformave në rajon. Është në interesin ekonomik dhe të sigurisë së BE-së dhe të rajonit, që Ballkani Perëndimor të bëhet pjesë e BE-së. Ky rajon ka dëshmuar të jetë një partner i besueshëm për sa i përket krizës së emigrantëve. Gjithashtu, referuar edhe lidhjeve të përbashkëta historike dhe kulturore, ky rajon është pjesë e rëndësishme e Evropës.

**Ballkani Perëndimor, në fokus të Presidencës austriake të Këshillit të BE-së**

Viti 2018 filloi me Presidencën bullgare të Këshillit të BE-së, për t'ia lënë stafetën në gjysmën e dytë të këtij viti Presidencës austriake e për të vazhduar vitin tjetër me atë rumune. Është vërtetë një mundësi mjaft e mirë për Ballkanin, që Presidencën e BE-së do ta mbajnë me radhë tri shtete, të cilat kanë në fokus Ballkanin Perëndimor, duke bërë kështu që me të gjitha sfidat gjeopolitike, me të cilat po përballëte Evropa, Ballkani Perëndimor të qëndrojë në qendër të vëmendjes.

Në këtë kontekst, Austria ka qenë dhe mbetet një ndër vendet më të angazhuara në favor të integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, duke artikulluar qartazi se BE-ja është e paplotë pa Ballkanin Perëndimor dhe se këto vende nuk meritojnë vetëm perspektivën evropiane, por me plotësimin e kushteve dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë meritojnë akoma më shumë anëtarësim në BE. Duhet theksuar se vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ecur përpara. Maqedonia dhe Shqipëria kanë marrë parimish një dritë jeshile për hapjen e negociatave me BE-në vitin që vjen, edhe pse Austria bashkë me vende të tjera evropiane do të kishin dashur që kjo të ndodhte që këtë vit.

**Prioritetet e Shqipërisë në sezonin e ri politik - "A little less**

**conversation, a little more action"**

E rëndësishme për Shqipërinë është që këtë periudhë më pak se një vit, ta shfrytëzojë në mënyrë maksimale, duke iu përkushtuar pjesës teknike të procesit të integritimit (screening process), por ç'është më e rëndësishme edhe reformave të nisura, që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar, si dhe duke u fokusuar tek reforma zgjedhore. Për të përmbytur këto detyra, qytetarët shqiptarë presin që përgjegjësit politikë në vend, qeveria e opozita dhe të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur prej qytetarëve të përveshin mëngët dhe të japin maksimumin. Për këtë nevojitet një qeveri që përpiqet të mbyllë 'gropat' dhe jo t'i lleshë ato, që është e orientuar drejt gjithëpërfshirjes dhe përlusës dhe jo drejt përjashtimit dhe të drejtës së më të fortit. Nga ana tjetër, nevojitet një opozitë, aksioni i së cilës të ketë si parim bazë kontrollin e punës së qeverisë dhe parashtrimin e kundërpozimeve realiste brenda institucioneve ligjore, për të qenë konkurruese në zgjedhjet e ardhshme. Dhe të dyja palët, për sa u përket çështjeve me rëndësi kombëtare, për të cilat nevojitet bashkëpunim, duhet të lënë mënjane retorikat partiake dhe të arrijnë një kompromis në të mirë të vendit.

Për mendimin tim, prioritare për këtë sezon të ri politik janë çështjet si: konstituimi i institucioneve si KLP, KLD dhe SPAK (pasi në këtë mënyrë mund të fillojë edhe vetingu i nevojshëm për politikë), miratimi i ligjit të magistraturës, si dhe bërja bashkë për reformën zgjedhore, duke marrë parasysh kërkesat e OSBE/ODIHR.

Nisur nga kjo, të dyja kampet politike duhet ta përdorin fushatën zgjedhore do të të nisë për të prezantuar konceptet dhe kandi-

datët e besuar, duke përfshirë fytirat e reja, sesa për të akuzuar njëri-tjetrin. Shqipëria është një ndër vendet me popullsi më të re në Evropë dhe një ripërtëritje politike do t'i shkente shumë për shtat, sidomos ripërtëritja e atyre që përballen drejtpërdrejt me shqetësimet e qytetarëve, pra të kryebashkiakëve.

Ajo çka nuk i duhet vendit është miratimi me nxitim dhe pa u shqyrtuar mirë i ligjeve veçanërisht të debatuar, si dhe një bojkot ose mospresencë parlamentare. Në të kundërt, duhet një aksion i përqendruar në interes të qytetarëve.

Pra, me pak fjalë dhe sipas të madhit Elvis Presley, "a little less conversation, a little more action, please!" (pak më pak fjalë, pak më shumë punë, ju lutem!)

Për të arritur këtë pjekuri demokratike është mjaft e vështirë, jo vetëm në Shqipëri, por e njëjta gjë vlen edhe në Austri ose vende të tjera. Për të gjithë, rruga drejt idealit të aftësisë për kompromis dhe pjekurisë demokratike është një përpjekje e përditshme. Kjo rrugë është thelbësore, sidomos në Shqipëri, ku polarizimi i forcave politike dhe sociale është veçanërisht i fortë. Kontributi i shoqërisë civile, i organizatave dhe grupeve të interetit është po aq i domosdoshëm sa edhe ai i mediave të pavarura.

Angazhimi i Austrisë në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE Pavarësisht ndryshimeve në kontekstin historik, ekonomik, apo të rrethanave gjeopolitike të të dyja vendeve, bërthama emarrëdhënieve me Austrinë dhe Shqipërisë ka mbetur po e njëjtë: ne jemi dhe mbetemi një partner i fortë dhe i besueshëm për Shqipërinë dhe një ndër mbështetësit më të besuar të përfarimit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Shqipëria nga ana e saj e ka futur Austrinë në katërshen e partnerëve strategjikë të vendit, gjë që thekson edhe më shumë veçantitë e marrëdhënieve tonë.

Në kuadër të Procesit të Berlinit,

Austria ka qenë që në fillim një pjesëmarrëse shumë aktive, duke nxitur një sërë projektesh rajonale, veçanërisht ato infrastrukturore, si ndërtimi i Autostradës së Paqes (Nish-Prishtinë-Durrës). Gjithashtu, ne kemi qenë mjaft aktivë edhe për sa i përket firmosjes së dy marrëveshjeve kufitare, si dhe kemi ndërmarrë nisim për përfshirjen e shoqërisë civile në projektet e Procesit të Berlinit.

Në këtë kontekst, në vazhden e angazhimit të saj, Austria në kuadër të Presidencës së Këshillit të BE-së, do të ndërmarrë një sërë nismash me fokus Ballkanin Perëndimor dhe integrimin e tij në BE. Ndër to mund të përmendim takimin e Gynnich-ut (31 gusht 2018), ndërmjet Ministrave të Jashtëm të vendeve të BE-së dhe vendeve kandidatë, ku një ndër pikat e rëndësishme të takimit ishte integrimi i Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, prezenca austriake do të dominojë fillim-vjeshtën e këtij viti në Tiranë përmes dy konferencave ministeriale: Konferenca e Ministrave të Evropës, që do të ketë në qendër mbështetjen reciproke në procesin e anëtarësimit dhe Konferenca e Ministrave të Brendshëm dhe të Drejtësisë, që do të ketë në fokus bashkëpunimin në çështjet për shkëmbimin e të dhënave dhe të migracionit.

Kjo nxjerr në pah jo vetëm rëndësinë e Ballkanit dhe të Shqipërisë për Austrinë, por tregon gjithashtu që Austria ia ka dalë që gjatë Presidencës së saj të vendosë Ballkanin në qendër të politikës së BE-së. Në vijim priten vizita dypalëshe. Përveç ministrave të Jashtëm, të Drejtësisë dhe të Brendshëm, Tiranën pritet ta vizitojnë edhe Kancelari Federal i Republikës së Austrisë, z. Sebastian Kurz dhe kryetari i Parlamentit, z. Wolfgang Sobotka. Pika kulmore e vizitave diplomatike do të jetë vizita e Presidentit Meta në tetor në Austri.

II. Roli i Evropës në botë

Që nga koha e themelimit të saj, Bashkësia Evropiane e Qymyrit dhe Çelikut dhe më pas Bashkimi Evropian ka siguruar paqe dhe prosperitet të pandërprerë për qytetarët e vet, duke u përhapur t'i eksportojë ato edhe në vendet që e rrethojnë. Bashkimi Evropian ofron për qytetarët e tij sistemin më të mirë në planet të mbrojtjes sociale dhe me diferencë nga të tjerët është kontribuuesi më i madh i ndihmës për zhvillim në botë.

Por, ashtu siç shprehet edhe presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, gjatë fjalimit të tij në 60-vjetorin e Traktatit të Romës: "Për të ndërtuar një botë të lirë duhet kohë, duhen përpjekje të mëdha dhe sakrificat, dhe Evropa ia ka dalë. Por asgjë nuk mund të merret e mirëqenë. Evropa si një entitet politik, ose do të ekzistojë si e bashkuar, ose nuk do të ekzistojë fare". BE ka nevojë për punë të vazhdueshme dhe angazhim për të mbështetur →

Opinioni Ditës


DËSHMI, PËRQAFIMI I LEOS...

Dita e parë e shkollës e "fshirë" nga kalendari i një 7-vjeçari

Nga Trëndafilë Visha

(vizon nga faqja 1)

... prej engjëlli u afrua në tavolinën tonë, ku po pinim kafë. Nuk tha asgjë, por m'u hodh në qafë. Kishte një aromë prej qumështi, si të një bebe disa muajsh.



tjetër, thua se i kishim falur botën.

- Si të quajné?
-Leo
-Leo?
-Si e ke emrin e plotë, Leo?
-lbrahim.

tjetër ku ishte një burrë rreth 55 vjeç. E kapi dhe atë për qafe. E puthiti fytyrën e tij me atë të burrit dhe ai shtangu.

hapi dorën dhe i renditi mbi pëllëmbë një 100 lekësh, një 50 lekësh, një 20 lekësh, një 20 lekësh dhe i tha: zgjidh!

Leo nguli gjatë vështrimit të monedhat. Kishte turp. Ishte një mëdyshje. Një fëmijë tjetër, do kishte zgatur dorën në cast, dhe ose do merrte 100 lekëshin, ose do i merrte të gjitha dhe sa hap e mbyll sytë do zhdukej.

projektit paqësor më të suksesshëm të përjetuar ndonjëherë në historinë e Evropës. Në një botë dhe shoqëri dinamike nevojitet që ky projekt i suksesshëm pajaje të zhvillohet e të përmirësohet gjithmonë e më shumë.

efektsmërinë e parimit të subsidiaritëti apo të thellojë kompetencat e saj mbi shtetet anëtare?

Reformimi i BE-së ka çuar në diskutimin, nëse BE duhet të thellojë kompetencat e saj mbi shtetet anëtare, pra të thellojë integrimin mes shteteve anëtare, apo të rrisë efektsmërinë e parimit të subsidiaritëti, që do të nënkuptonte ndarjen e kompetencave dhe përjashtimin e ndërhyrjes së BE-së, kur një çështje mund të trajtohet në mënyrë efektive nga shtetet anëtare në nivel qendror, rajonal ose lokal.

mpetencave të BE-së ndaj shteteve anëtare dhe se në cilat fusha do të ishte më efektive vendimmarrja lokale. Parimi i subsidiaritëti do të rriste rolin e shteteve anëtare për të marrë vendime sa më afër interesave dhe pikëpamjeve të qytetarëve në fushën e shëndetësisë, industrisë, kulturës, turizmit, arsimit të përgjithshëm dhe profesional, sportit, në çështjet e përfshirjes së të rinjve, në mbrojtjen nga katastrofat dhe bashkëpunimin administrativ.

anëtare ndaj këtij parimi. Nënverësimi i këtij parimi nga BE-ja u përdor nga mbështetësit e Brexit kundër vetë BE-së. Por deri tani maksimumi që ka mundur të bëjë BE-ja në këtë drejtim ka qenë përshtatja "ad-hoc".

Evropa ka nevojë të rrisë

HOROSKOPI DASHI DEMI BINJAKET GAFORJA LUANI VIRGJERESHA PESHORJA AKREPI SHIGJETARI BRICJAPI UJORI PESHQIT

**KËNAQËSIA E ISH-PORTIERIT**

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, e ka cilësuar të merituar fitoren dhe kryesimin e kampionatit. Në fjalët e tij në "Gol pas goli", ai theksoi se ekipi kishte bërë gjithçka mirë deri tani në këtë kampionat me emra të rinj. "Edhe pse janë të rinj, kanë qenë pjesë e jona, por nuk kanë pasur minuta.



Ata rriten me frymën tonë në vite, kanë dëshirë për të fituar dhe meritojnë përgëzime. Jemi të kënaqur me pikët që kemi marrë, por më shumë se si i kemi marrë. Nuk i kemi marrë rastësisht, por duke prodhuar lojë. E kam thënë që ndeshja jonë do të jetë e radhës dhe aty do të fokusohemi. Kërkuam agresivitet të çdo lojtar. Në minutat e fundit

**Shehi: Jemi skuadra për t'u mundur, Radas luajti me injeksione**

të pjesës së parë hymë në presion kot, duke i dhënë hapësirë kundërshtarit. Pasi kemi hyrë pas pjesës së parë, i kërkuam lojtarëve që të ngjiten më lart. Skuadra vendase përfitoi nga tërheqja jonë dhe euforia e publikut, por ishte gabimi ynë

që i lamë hapësira, pastaj korrigjuam gjithçka. Radas kishte probleme, kurse Kristi la stërvitjen para kohe këtë javë. Edhe pse kisha shpresë se e përballonin lojën sot, problemi më i madh vinte nga Radas se kishte dhimbje mesi. Ai

sakrifikoi që të mos humbiste ndeshjen, duke luajtur me injeksione. Unë do të kërkoja dhe insistoj të skuadra që të jemi ne skuadra për t'u mundur javë pas javë. Ne duhet të luajmë me ego për të dhënë maksimumin në ndeshje, pavarësisht rezultatit. Po dhama këto, jemi të sigurt që do të dalim me rezultat pozitiv".

"Nxënësi" Shehi fiton sfidën me "mësuesin" Daja. Golat u shënuan nga Krasniqi e Oto Xhon



Jeton Selimi

**Skënderbeu tregon "dhëmbët" në Vlorë**

*Flamurtari-Skënderbeu mbyllet me rezultatin 0-2*

Skënderbeu "bastis" Vlorën dhe kthehet në Korçë me tre pikë pas fitores 2-0 ndaj Flamurtarit. Golat e Krasniqit dhe Oto Xhonit vulosën suksesin bardhekuq, që tashmë merr i vetëm kreun e renditjes. Ndërkohë mjaft interesante përballja mes Ilir Dajës dhe Orges Shehit, me nxënësin që arrin të mposhtë mësuesin e tij.

Ishte dueli i parë për kreun. Skënderbeu kampion që udhëtonte në Vlorë, aty ku i priste Flamurtari, ose ekipi që është cilësuar më shumë si rivali kryesor i korçarëve. Por brenda kësaj sfide kishte edhe një përballje tjetër interesante, ajo mes Ilir Dajës dhe Orges Shehit, mësuesi që vihej përballë nxënësit me të cilin pak muaj më parë kishte ngritur trofeun e fundit të kampionit.

Sfida nis e fortë, por kryesisht luhet në mesfushë, ndonëse ngacmimet në portat respektive nuk do të mungojnë, si në rastin e Flamurtarit në minutën e 7-të, apo të Skënderbeut në minutën e 16-të. Në fund të pjesës së parë, Gripshi në zonë do të pretendojë penallti pas kontaktit me Siljanovskin, por Andi Koçi do



t'i japë durrsakut kartonin e verdhë për simulim. Pjesa e dytë do të jetë më agresive, ndërsa edhe tifozët do të bëjnë të tyren duke detyruar Andi Koçin ta ndërpresë takimin (minuta 60), ndërsa Skënderbeu do të godasë në mefshtësinë e vetme të mbrojtjes vlonjate, atëherë

në minutën e 73-të topi i harkuar nga Radas mbërrin te Krasniqi që godet saktë duke çelur rezultatin. Flamurtari do të përpiqet të barazojë, por nuk ka forcën e duhur, ndërsa, nga ana tjetër, gabimi i Veliut i jep mundësinë e kundërsulmit Skënderbeut në minutën e 86-të,

kundërsulm që finalizohet me gol në nga Oto Xhon, i cili mposht Koliçin në shtyllën e tij. 2-0 për kampionët, dhe stadium "Flamurtari" nis të zbrazet me shpejtësi nga tifozët, që duket se po shohin fantazmat e sezoneve të fundit, ku pavarësisht bujës në merkato, skuadra është

**MINUTA E 86-TË**

Tifozët e Flamurtarit nisën të largohen nga stadiumi menjëherë sapo ekipi i tyre pësoi golin e dytë. Madje edhe anëtarët e "Flotës Kuqezi" u larguan duke braktisur sektorin e tyre dukshëm të zhgënjyer. Në Vlorë besonin se do të merrnin tjetër rezultat, por ekipi në fushë nuk ia doli mbanë.

shfryrë me kalimin e javëve. Krejt ndryshe situata për Skënderbeun, që merr kreun i vetëm dhe në javën e 4-të e sheh veten sërish aty ku e mbylli sezonin e shkuar.

**SUPERLIGA**

**JAVA E 4-t**

**TË SHTUNËN**

Kamza - Kastrioti	2-0
Teuta - Kukësi	0-1

**TË DIELËN**

Laçi - Partizani	0-0
Tirana - Luftëtari	3-1

**TË HËNËN**

Flamurtari - Skënderbeu	0-2
-------------------------	-----

**Renditja**

Skuadra	N	P
Skënderbeu	4	10
Kukësi	4	7
Partizani	4	7
Flamurtari	4	7
Laçi	4	6
Kamza	4	6
Teuta	4	5
Tirana	4	4
Kastrioti	4	3
Luftëtari	4	0

**JAVA E 5-të**

**TË PREMTEN**

Partizani - Flamurtari	9:45
------------------------	------

**TË SHTUNËN**

Luftëtari - Teuta	15:45
Skënderbeu - Tirana	18:45

**TË DIELËN**

Kastrioti - Laçi	15:45
Kukësi - Kamza	18:45

**TRAJNERI I FLAMURTARIT**



Trajneri i Flamurtarit, Ilir Daja, nuk ka kursyer aspak kritikën ndaj futbollistëve të tij. Daja nuk ka thënë emra të përveçëm, por në fjalët e tij për "SuperSport", kritikoi hapur "ekspertët" në radhët e skuadrës së tij. "Unë nuk mund të bëhem trajner në ekip të parë që t'u mësoj lojtarëve marrjen dhe pasimin e topit se është problem i madh. Do të thosha që komponenti i parë që duhet të përmirësojmë është ana psikologjike se edhe në ndeshje e kaluar, mbaruam pjesën e parë


**Daja shpërthen ndaj të tijve: Lojtarëve ekspertë nuk mund t'u mësoj unë pasimet**

1-0 dhe pastaj punojmë ndryshe nga stërvitja për të mbrojtur. Do të doja që lojtarët e mi të vlerësojnë në maksimum vlerat individuale që pastaj të bëhen pjesë organizative e grupit. Zemërimin e kisha me një individ të veçantë se të gjitha gjërat janë të punuara në stërvitje. Janë gjëra që nuk ia lëmë rastësisë, edhe në seanca stërvitore këto goditje dënimi. Ai është

të lojtar me eksperiencë këtu në Vlorë, gjithçka është e parapërgatitur dhe nuk mundet asnjëri, kushdo ky, që të dalë mbi disiplinën taktike. Kjo sollti parregullsi në atë goditje standarde. Duhet të kthejmë besimin te lojtarët që brenda këtij grupi ka cilësi. Ky është reflektim edhe nga viti i kaluar, ku në përballje me Skënderbeun, Flamurtari kishte bilanc negativ, jo

doja të ndryshonte. Ramë në presion, jo të asaj që na vuri në vështirësi kundërshtarit, ishim të mbingarkuar, shkuam më shumë se sa duhet në nivelin e përgjegjësisë. Kjo kalon në stres dhe e pamë që lojtarë me eksperiencë në Superiore e jo vetëm, kishin mangësi në gjëra më të thjeshta, kjo duhet përmirësuar. Një lojtar si Pollozhani me gjithë atë eksperiencë, vihet nën presion në një hapësirë të madhe, këtu ka diçka që nuk shkon", përfundoi Ilir Daja.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. I famshëm ai i Delfit.
8. Ai elektoral që duhet kapërcyer.
13. Një raketë... atdhetare.
14. Val aktor.
15. Kazan regjisor.
16. Pak formalitet.
17. Eshhtëa Au në tabelë.
18. Të fundit në surf.
19. I mbjell... katastrofa.
24. Fillojnë masat.
25. I bëjnë të luajturit.
26. Mbyllin një krah.
27. Janë trupa qiellore.
28. Preferojnë vjet e hënën.
29. Vanessa violiniste.
31. Beton pa kufij.
32. Ente Operative Tiranë.
33. Winslet aktore.
34. Një stacion... anijesh.

36. Atëherë kur dalin vjet.
39. Një djalë vajze.
40. Këndohet në opera.
41. Pak elementare.
42. Një pjesë e origjinës.
44. Eshhtë bota jashtë ëndrrës.
46. Eshhtë shuma e përgjithshme.
48. Totale pa zë.
49. Merret me të bukurën.

**VERTIKAL**

1. Eshhtë melodramë.
2. Një Schumacher... jo kampion.
3. Ai i shenjtë është Papa.
4. Lidhet në... fyt.
5. Arturo i Brecht.
6. Fillojnë lojën.
7. Luhet në ekstreme.
8. Kishin flamurtë zi.
9. Role pa zë.
10. Pak amatoriale.
11. Eshhtë shkronjë.
12. Personazh i Dickens.
14. Ishin bashkitë dikur.
16. Eshhtë edukimi në palestër.
20. Papas aktore.
21. Qytet italian.
22. Një pëlhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
25. Një monument... për kujtim.
27. Mund të jenë me katër kohë.
28. Një ushtarak me... numër.
29. Kryeqyteti i Filipineve.
30. Ai i shenjtë është papa.
35. Një pjesë e talenteve.
37. Numri i oktetit.
38. Eshhtë sport me stil të lirë.
43. Gjysmë raketë.
45. Ekstreme në ekstreme.
47. Fundi i turandot


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Eshhtë baba.
5. Të fundit në studim.
7. Gustave, piktori që ilustroi Komedinë Hyjnore.
11. Lidhin brigje.
12. Mban në kokë një tiara.
14. Janë poezi.
16. Qetësonte detin.
17. Koloneli i shkurtër.
18. Inicialet e Mallë regjisor.
19. Mbeten në fund.
22. Satelit i Jupiterit.
23. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
25. Thirrej El Pibe de oro.
27. Eshhtë shkakitari i sherrit.
29. Një vegël edhe Stradivari.
30. Fillojnë një periudhë.
31. Bukuroshja e Eunooes.
32. Kështu thirrej Felix Tournachon.
35. Del Piero për tifozët.

**VERTIKAL**


1. Eshhtë galeri në hekurudhë.
2. Një mund të jetë cirku.
3. Pishtarë pa pishë.
4. Matet pa kufij.
5. Mbyllin një princip.
6. Mund të jenë spaghetti të tilla.
7. Këndonte Ciao amore ciao.
8. Prodi që u pasua nga Berlusconi.
9. McBain shkrimtar.
10. Eshhtë shtypja në barometër.
13. Ishte kombësia e Chopin.
15. Fara këngëtare.
20. Vrau Goliathin.
21. Një i mbijetuar nga Sodoma.
24. Janë nofka.
25. Eshhtë frut i sherit.
26. Në krye të arnatës.
28. Teket e një rrote.
29. Kilmer aktor.
30. Përhapet me frikë.
31. Parashitesë zmadhuese.
32. Në krye të komandës.
33. Afrohen nga kreu.
34. Ishte futbolli i famshëm për një gjete të thatë.
37. Ndiqet me ilaç.
39. Agjenci Martesore Rumune.
41. Kastile janë në fund.
44. Hapen në kufij.
45. Fund janari.
46. Inicialet e Gide.
48. Të parat në olimpiadë.
49. Në krye të titullarëve.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

						7	1
3			8			5	9
		2			8		
	2					9	1
		6					3
7			4				
	4	9				3	2
	5		7			4	8
	2	3			6		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

8	6	2	9	7	3	1	4	5
7	5	3	1	2	4	8	6	9
9	1	4	5	6	8	2	7	3
1	4	9	7	5	2	3	8	6
2	7	6	8	3	1	9	5	4
3	8	5	4	9	6	7	2	1
4	2	1	6	8	9	5	3	7
6	3	7	2	1	5	4	9	8
5	9	8	3	4	7	6	1	2

*Argëtim filozofik*

- Vlera e njeriut është kuantiteti i energjisë morale, intelektuale dhe fizike që gjenden në kraheorin e tij.
- Njerëzit dinakë urrejnë shkencën e adhurorin primitivizmin, kurse të mençurit këtë e shfrytëzojnë.
- Nuk mund të detyrosh veten tënde të dashurojë, dhe pikërisht kjo është vlera e dashurisë.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

1	H	A	R	11	K	16		3		8	9	11	T	R	A	P	A	E	F	I	K	A	S		
6	3	9		3	9	8	2	4	7		6		H	E	R	O	I	Z	M	I	P	A	K	O	
4	2	5	5		13	6	4	4	2	8			E	K	T	P	A	P	A	T	L				
6	12		6	16	7	4	9	8	9	6			S	P	E	R	A	N	D	O	R	I	A		
3	7		1	7	8	6	10	2	8	6	10			T	E	R	E	N	C	E	H	I	L	L	
7		1	6	3	6	12	7	4	6	6				D	E	T	E	K	T	I	V	I	E	K	S
15		7	4	6		6		6	12	7	10			A	N	E	U	A	N	M	A	T	I	A	
6	4	3	9	10	7	4		13	14					M	O	R	R	I	P	I	M	Z			
10	6	4	6		12		5		6	4	10			A	R	R	I	E	A	H	I	E			
11	6	12	10	6	10	6		10	4	6				R	E	A	L	S	E	L	L	E	R	S	
6		9	6	14		6	3	6			4			E	C	A	R	A	M	A	N	E	T	I	
3	9	11			3	4	6	16		3	7			T	R	A	K	T	I	A	A	Z	I	L	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A M O K A K F E S T A T  
 F A R U K S H Q Y T A R I  
 T L V A I E A N M  
 A V E N D O S M E R I A  
 M E R C E N A R E T R G  
 P A R T E N O P E A F E J  
 K O B A L T E K L A N A S  
 R A A I T U N E L E T  
 M E T L E T I L O J A E  
 A T E L I T I D G R I  
 R T I T I D G R I  
 S P O R T I S T E P A R A

**FJALËKRYQI (2)**

K U P A D A S M A T  
 R R T R K S T I R T A K I  
 P E R T I U D H A T K T M  
 D I M E N S I O N E T L E  
 S T I N T A K S A T O I L  
 T E I O R T L E T R A  
 Z A R A R E A S I R E T  
 A R A E T I K E T A T  
 N D S T K O R R J A O  
 A L A T R A V I A T A R  
 T A L B O T I A A J A T  
 I D E A K Y C S T U F A

*Thënie të mençura*

- Flisni për gjërat e mira që keni në jetën tuaj, më shumë se të flisni për problemet tuaja.
- Mos u shqetësoni shumë për njerëzit që nuk janë të shqetësuar në lidhje me ju.
- Koha është i vetmi kritik pa ambicie personale.
- Një udhëtim një mijë kilometra fillon me një hap.
- Nëse nuk ndryshon drejtim, mund të përfundosh atje ku shkon.



Universiteti  
Europian i  
Tiranës

maiora premunt/ gjëra të mëdha na presin

## ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË

5 Diploma Profesionale / 26 Programe Bachelor / 1 Program i Integruar



DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI  
I EKONOMISË BIZNESIT  
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE  
JURIDIKE, POLITIKE  
DHE MARRËDHËNIEVE  
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI  
I SHKENCAVE HUMANE  
EDUKIMIT DHE  
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI  
I INXHINIERISË,  
INFORMATIKËS  
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI  
I SHKENCAVE  
MJEKËSORE TEKNIKE

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al

